

## **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE NE PUNE**

**Veshtrim kahasues ligjor i procedurave jashte-gjyqesore dhe  
gjyqesore ne Bashkimin European, ne Zvicer dhe ne vendet e  
Europees Jug Lindore**

Wiebke Düvel  
Isabelle Schömann  
Grigor Gradev  
Stefan Clauwaert

Instituti i Sindikatave Europiane  
Bruksel, 2005

Brussels, 2005  
© Publisher: ETUI, Brussels  
All rights reserved  
Print: ETUI Printshop, Brussels  
D-2005-3163-05  
ISBN: 2-930352-67-1

ETUI mbeshtetet finansiarisht nga Komisioni Europian.

## Tryeza e lendes

<b>Parathenie .....</b>	5
<b>Hyrje.....</b>	7
<b>Pjesa I: Zgjidhja alternative e mosmarreveshjeve</b>	
<b>Pajtimi, Ndermjetesimi, Arbitrimi .....</b>	11
<i>Isabelle Schömann</i>	
Hyrje.....	13
Mekanizmat e zgjidhjes alternative te mosmarreveshjes: Nje veshtrim krahasues .....	13
Veshtrim nderkombetar i ZAM.....	14
ZAM ne Bashkimin European .....	16
ZAM ne Shtetet Anetare te BE: nje metode e mire-percaktuar e drejtesise private ne Europe .....	17
Karakterististika te perbashketa te procedurave kombetare ZAM ne Shtetet Anetare te BE .....	19
Kufizimet e sistemeve ZAM: territorialiteti i vendimeve ZAM .....	20
ZAM ne vendet e Europes JugLindore .....	20
Konkluzione .....	22
<b>Pasqyra: Veshtrim krahasues mbi pajtimin, ndermjetesimin, arbitrimin.....</b>	23
<b>Pjesa II: Sistemet e gjykatave te punes ne Bashkimin European dhe ne Europen Juglindore</b>	
<b>Veshtrim krahasues .....</b>	31
<i>Wiebke Düvel</i>	
Hyrje.....	33
Gjykatat e punes ne Bashkimin European – veshtrim krahasues .....	34
<b>Shembuj nga vende te ndryshme .....</b>	41
Rregullimi i mosmarreveshjeve ne pune ne Gjermani .....	43
Zgjidhja e mosmarreveshjeve ne pune ne Hungari (Judit Ivány Czugler) .....	47
Gjykatat e Punes ne Zvicer (Jean-Claude Prince).....	61
Zgjidhja e mosmarreveshjeve ne pune ne Europen Juglindore.....	71
Pasqyra: Veshtrim krahasues i gjykatave te punes ne BE .....	75
<b>Bibliografia .....</b>	95



## **Parathenie**

Ne 1 Maj 2004, Bashkimi European mirepriti ne gjirin e vet 10 shtete te reja anetare. Duke u ndalur ne kete moment historik, nuk duhet te harrojme se dy vende te tjera te Europes JugLindore jane ende ne pritje te pranimit ne BE. Me zgjerimin e vet, BE ka perftruar kufinj dhe fqinjesi te re qe shtrihen me tej ne drejtim te Lindjes. Ndaj vendeve te Europes JugLindore,BE ka perpunuar nje strategji rasonale te vecante ne formen e procesit te asocim-stabilizimit.

ETUC (Konfederata e Sindikateve Europeane) eshte e mendimit se sindikatat duhet te luajne rol dhe te kene perjegjesite tyre ne kete proces stabilizimi dhe transformimi. ETUI mbeshtet sindikatat lokale duke e bere keshtu me te lehte procesin e institucionalizimit te dialogut social ne rajon nepermjet zhvillimit te bazes ligjore te marredhenieve ne pune dhe fushave qe lidhen me reformat ekonomike dhe sociale. Ne vitin 2002, NETLEX (rrjeti i eksperteve ligjore te sindikatave) u rajonalizua, dhe ne kete kontekst, u krijuva nje rrjet i ri per ekspertet ligjore te sindikatave ne vendet e ish-Jugosllavise si edhe ne Shqiperi,Bullgari dhe Rumani. Projekti eshte nje platforme qe u jep mundesi sindikalisteve te diskutojne probleme me interes te ndersjelle dhe te shkembejne informacion dhe ide. Ai synon te mbledhe te dhena nga rajoni dhe te shperndaje informacionin e duhur, keshilla dhe analiza mbi ceshtje te ligjit te punes; te krijoje lidhje direkte mes sindikatave dhe Europes se zgjeruar; si edhe te organizoje trajnime per juristet e sindikatave.

Ne vitin e dyte te punes se vet, rrjeti u perqendrua kryesisht ne problemin e zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune, duke hedhur veshtrimin si mbi zgjidhjet jashte gjyqesore: pajtim,ndermjetesim dhe arbitrim, ashtu edhe mbi metodat me tradicionale gjyqesore nepermjet gjykatave te punes. Keto ceshtje jane trajtuar ne dy konferanca rasonale si edhe ne takimet kombetare te zhvilluara ne Bullgari, Rumani dhe ne Shqiperi.

Botimi i dyte ne kete projekt, ne vijim te raportit 78 te ETUI-t ” Marredheniet e Punes ne Europen JugLindore – Nje veshtrim ligjor ne 2003” ndjek nje linje krejt te re. Ne kete rast, rapporti synon te sherbeje si “udhezues” per sindikalitet ne rajon ne kuadrin e nje pasqyrimi sa me te mire te sistemit per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune. Raporti jep informacion lidhur me ceshtjet e mesiperme, mbi te cilat u perqendrua edhe projekti ne vitin e dyte te tij.

Falenderimet tona i takojne Agjencise Zvicerane per Zhvillim dhe Bashkepunim per ndihmen e dhene- brenda kuadrit te Iniciatives per Kohezion Social te Paktit te Stabilitetit per Europen JugLindore, qe financoi projektin i cili ne vitin e trete do te trajtoje, mes te te tjerash, edhe problemet e ekonomise informale ne rajon.

Henning Jorgensen

Drejtor i ETUI-t

Qershori 2004



## Hyrje

Ky botim vazhdon me tej me nje veshtrim<sup>1</sup> analistik te kuadrit ligjor, qe perben bazen per zhvillimin e marredhenieve ne pune dhe dialogun social ne rajonin e Europees Juglindore. Studimi i referohet disa prej sfidave te identikuara ne fillim te vitit 2003, por ne nje menyre me te perqendruar e me te detajuar si edhe ne nje forme te mirepritur nga perdoruesit –si pike/burim reference per t'u zbatuar ne praktike.

Institucionalizimi i sistemeve per arbitrim dhe pajtim avancoi me shpejtesi ne disa vende te rajonit dhe rezultatet e para i dha ne vitin 2003. Puna ne kete drejtim ka vazhduar dhe rrjeti vendosi te ndalej ne zhvillimin e sistemeve efikase te gjykatave te punes ne vendet e rajonit, si teme kryesore e veprimtarive te veta per vitin 2004. Ngjarjet e fillimvitit 2004, konfirmuan si orientimin e drejte ashtu edhe kohen e duhur per kete zgjedhje. Gjate gjysmes se pare te vitit, ne Rumani, dispozitat ligjore egzistuese ne kete fushe u rishikuau dhe u ndryshuan me qellim qe te beheshin sa me te zbatueshme dhe efikase ne kushtet e jetes reale. Ne Bullgari, ne vijim te workshopit te projektit<sup>2</sup>, u ngrit nje grup pune, ne perberje te te cilit merrnin pjese specialiste nga ministrite e punes dhe mjedisit, punedhenes dhe sindikata, per te percaktuar sistemin e gjykatave te punes dhe per te hartuar legjislacionin e nevojshem per zbatim. Ne Maqedoni, ne Serbi dhe ne Shqiperi, nevoja per ngritjen e gjykatave te punes eshte njojur dhe percaktuar si nje politike e kushtezuar nga keshillat ekonomike dhe sociale dhe nga marreveshjet midis qeverise dhe partnereve sociale.

Rendesa e funksionimit efikas te sistemeve te tilla ne rajon, nuk duhet mbivleresuar. Bullgaria perben nje shembull te qarte ne kete drejtim. Ajo i ka perfunduar bisedimet per anetaresim ne BE, pra kuadri legjislativ dhe institucionet qendrore te marredhenieve ne pune jane ne perputhje me standartet e BE-se. Megjithate, ne workshopin e Sofies Ministri i Drejtseise leshoi sinjalin e alarmit duke iu referuar shifres se 16.000 rasteve te reja te paraqitura ne gjykate vetem gjate vitit 2003. Numri me i madh i rasteve, ndoshta gati 90% apo me teper, lidhet me problemet kryesore te marredhenieve ne pune: me sigurimin ne pune (pezullimet e paligjshme nga puna), pagat (rrogat e papaguara) dhe sigurimet shoqerore (kontributet e papaguara te fondit te pensioneve dhe kontributet e sigurimeve shendetsore). Kjo situate paraqitet ne nje sistem ku Kodi i Punes i miratuar ne vitin 2001, ne fjalet e Ministrit te atehershems te Punes, parashikon me teper se njeqind raste te pezullimit te marredhenieve te punes ne menyre te ligjshme.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> W. Duvel, I.Schoman, S.Clauwaert and G.Gradev (botimi) *Marredheniet e Punes ne Europen JugLindore: Nje Veshtrim Ligjor ne 2003*, ETUI, Bruksel,2003.

<sup>2</sup> “Rrjeti i Eksperteve Ligjore te Sindikatave ne Europen Juglindore”- Projekt i drejtuar nga ETUI me mbeshtetjen e Agjencise Zvicerane per Zhvillim dhe Bashkepunim brenda Iniciatives per Kohezion Social te Paktit te Stabilitetit per Europen Juglindore.

<sup>3</sup> Ministri i Punes dhe Politikave Sociale, Ivan Neikov, paraqet projekt Kodin e Punes ne takimin e anetareve te Shoqates Bullgare te Industrie.

Gjithesesi, kjo tablo perfaqeson jo me shume se pjesen e dukshme te problemit. Nje numer i konsiderueshem rastesh nuk arrin ne fazen e procedurave gjyquesore per nje sere arsyesh, te cilat ushtrojne nje ndikim te fuqishem shkurajues mbi personat qe kerkojne te drejtat e tyre, sidomos kur ketu perfshihen grupet e minoritetit.

Disa nga arsyet me te rendesishme qe ia vlen te permenden jane:

- Niveli per gjithesish i ulet i besimit tek institucionet publike
- Mungesa e ndergjegjesimit te individeve mbi njohjen e te drejtave qe ata duhet te gezojne, si edhe e informacionit te munguar per mbrojtjen e ketyre te drejtave ne praktike, sidomos ne ndermarrjet e vogla dhe te mesme (jo ne sindikata) dhe ne fshat.
- Mungesa e burimeve te mjaftueshme per kete qellim, sidomos ne fshat ku shpenzimet e udhetimit deri ne qytetet ku ka gjykate, e bejne te pamundur paraqitjen e individeve ne to, madje edhe ne rastet kur procedurat gjyquesore jane falas.
- Logjika e strategjive te mbijeteses qe ne menyre te paevitueshme dikton zgjedhje ne rrrethana te tilla, psh.kursimet e pakta duhen perdonur per gjetjen e nje pune te re se me pare te jete e mundur, dhe jo per ndjekjen e procedurave ligjore qe s'dihet si perfundojne, edhe ne rastet kur çeshtja fitohet.

Duke marre parasysh kohezgjatjen e procesit, nje çeshtje gjyquesore shkon mesatarisht nga 1.5 - 5 vjet deri ne arritjen e nje zgjidhje perfundimtare - duket sikur me shume se 2% e atyre qe punojne me nje kontrate pune (numri i per gjithshem ne Bullgari per vitin 2003 ishte afer 2 milion), e kane jeten e tyre (dhe te familjeve te tyre) te varur nga pasigurite ligjore. Eshte krejtesisht e qarte se kjo gje nuk ndihmon per krijimin e nje kulture te marredhenieve te mirekuptimit ne pune, per stabiliteten social dhe per krijimin e besimit tek institucionet nga njera ane dhe midis partnereve sociale nga ana tjeter.

Keto dukuri ndikojne drejtperdrejt ne qendrimet mbi politikat reformuese si edhe ne integrimin ne BE dhe vec kesaj e bejne me te nderlikuar sfiden e procesit te pranimit. Sikurse konstatohet nga Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) ne nje vezhgim te perpikte te dhjete viteve te para te tranzicionit "Mesimi baze i tranzicionit eshte se tregjet nuk mund te funksionojne sic duhet pa ndihmen e institucioneve qe i mbeshtesin, pa nje shtet qe realizon per gjegjesite e veta themelore dhe pa nje shoqeri te shendetshme civile". Brenda te gjitha politikave transformuese,ndertimi i institucioneve mbetet shtylla kryesore e kryerjes se reformave ne çdo fushe te ndryshimit te sistemit - politik,ekonomik dhe social. Raporti i BERZH-it trajton kryesisht zhvillimet ne keto drejtime: "Masat institucionale, qe mund te duken te shendetshme nga nje pespektive formale apo e shkruar (psh.legislacioni), mund te minohen nga modelet dhe kodet e qendrimeve, qe pengojne funksionimin positiv te tyre"<sup>4</sup>. Funksionimi i sistemeve gjyquesore ne fushen e ligjit te punes ne shoquerite ne tranzicion, ne kete rast, do te sherbeje si nje shembull mjaft i qarte per çeshtjet ne fjale.

Nje nga rolet kryesore qe kane gjykatat ne rregullimin e tregjeve te punes dhe marredhenieve ne pune, eshte te percaktoje fushen brenda se ciles dispozitat ligjore dhe marreveshjet mes paleve te interesuara cojne ne percaktimin e normave te pranuara qe aplikohen nga bordi, si

---

<sup>4</sup> Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) *Raporti i Tranzicionit 1999: Dhjete vjet tranzicion*, Londer, 2000, fq.5

edhe te ndaloje lojtaret individuale t'i kundershtojne apo t'i shkelin keto norma, psh. te dalin jashte loje ose te krijojne norma te reja ne vend te tyre.

Me fjale te tjera, sistemi gjyqesor eshte gjithashtu nje burim i rendesishem nxitjesh per te njohur interesat kolektive te seciles nga te dy partneret dhe per te inkurajuar perfaqesimin e tyre te organizuar, psh. per te ushtruar funksionin e tyre "me ze" (per te ngritur zerin)<sup>5</sup> per rregullimin e sistemeve te marredhenieve ne pune. Gjithesesi, ne kushtet e ekonomive dhe shoqerive "ne tranzicion", keto nxitje mund te marrin nje karakter tjeter.

Me kryesorja eshte se rastet e mosmarreveshjeve ne pune, trajtohen nga sistemet e gjykatave te per gjithshme te cilat jane te mbingarkuara, ne nje kohe qe behet rishikimi total i te gjitha sistemeve shoqerore dhe i jeteses se cdo familje apo individi. Situata e sotme ben qe zgjidhjet e mosmarreveshjeve ne pune te kene nje ndikim te vogel, si rezultat i nje procesi gradual, ne percaktimin e standarteve te mirenjhura dhe te pranuara te menazhimit te marredhenieve ne pune. Faktori i dyte kryesor eshte kohezgjatja e procedurave. Ajo eshte shume e gjate dhe shpesh aq e gjate sa zgjidhja perfundimtare ndikon fare pak mbi konfliktin fillestar, dhe si rrjedhoje aktoret zor se binden per nevojen e standarteve dhe marreveshjeve. Pikerisht ne kete rast, kombinimi aktual i sistemeve gjyqesore me procedurat e reja te arbitrimit dhe pajtimit vullnetar, shpesh mund te sjelle rezultate paradoksale.

Skema aktuale e funksionimit te gjykatave, ne vend qe t'i detyroje aktoret te pajtohen me ligjin dhe me perfaqesimin e organizuar te interesave, ne fakt krijon mundesi per "exit" - (per dalje nga skena); shume shpesh shpenzimet e vazhdueshme per t'u ripunesuar, jane praktikisht me te medha sesa shpenzimet qe nevojiten per te zgjidhur rastet e shkeljeve te ligjit te punes dhe vazhdimin e procedurave gjyqesore, apeleve, vonesave dhe rezultatit te sigurt negativ per punedhenesin. Ne kete menyre, shmangia nga perfaqesimi i organizuar dhe dhunimi i ligjit te punes shnderrohen ne nje strategji te suskeseshme per nje punedhenes te vetem, ne nje fushe tjeter veprimi per dialog social, duke zbehur, keshtu, nevojen per standarte te reja dhe besimin tek forca e ligjit ne shoqeri. Ne nje perspektive me afatgjate, pasojat mund te jene shume me te medha se sa rasti i vecante, gje qe nuk lejon grumbullimin e "kapitalit shoqeror" dhe krijon pengesa per funksionim efikas te tregut dhe te shtetit, sikurse nenvizohet edhe nga BERZH.

Zhvillimet ne vitin 2004 theksojne nevojen e procesit te njohjes se sfidave ne kete fushe dhe ne nje fare mase, gatishmerine e qeverise dhe partnereve sociale ne rajon per te ndermarre masa ne lidhje me per dorimin e procedurave efikase te pajtimit dhe arbitrimit si edhe per te ngritur gjykata te specializuara te punes brenda sistemeve gjyqesore. Ne te njejten kohe, cdo trajtese serioze duhet te vere ne dukje qe ky nuk eshte nje projekt kaq i thjeshte sa te jape rezultate magjike brenda nates.

Ai nenkupton pershtatje te rendesishme institucionale dhe financiare dhe e ben te domozdoshme teknologjine e re per transferimin e rasteve egzistuese ne nje sistem te ri procedurash (duke perfshire partneret sociale), pa rrezikuar mundesite e barabarta ne secilin rast, lidhjet funksionale te gjykatave te shkalles se pare dhe te dyte, procedurat e apelit etj. Sikurse edhe ne fusha te tjera te politikave reformuese, percaktimi i sistemeve qe do t'i pershtaten kushteve te vendit dhe hapave llogjike qe duhen ndermarre per zbatimin e tyre, ka

<sup>5</sup> Hirschman A. *Exit/Dalja, Zeri dhe Besnikeria: Pergjigje per Renien e Firmave, Organizatave dhe Shtetete, Shtypi i Universitetit te Harvardit*, 1972.

mjaft rendesi. Keto sisteme duhet te specifikohen qarte dhe te mbeshteten ne nje konsensus sa me te gjere. Per arritjen e ketij qellimi, qeverite, sindikatat, punedhenesit dhe njerezit e ligjit duhet te angazhohen ne kete proces qe ne castin e pare.

Ky botim synon te jape nje kontribut modest per ta bere sa me te lehte ngritjen e gjykatave te qendrueshme te punes dhe per te kriuar sistemet e arbitrimit dhe pajtimit ne Europen JugLindore. Meqenese eshte e qarte se aktivitetet praktike ne kete fushe, ne te ardhmen do te vazhdojne ne te gjithe rajonin, botimi eshte perqatitur gjithashtu ne gjuhen serbe dhe ne gjuhen shqipe per te gjetur nje numer sa me te madh perdoruesish.

Grigor Gradev

Koordinator i Projektit te ETU-it

Koordinator i ETUC-it per Paktin e Stabilitetit ne Europen Juglindore

## **Pjesa I**

**Zgjidhja alternative e mosmarreveshjeve**

**Pajtimi, Ndermjetesimi, Arbitrimi**

Isabelle Schömann



## Hyrje

Mekanizmat per zgjidhjen e mosmarreveshjeve jane nje elementet kyc i te gjitha sistemeve te marredhenieve te punes ne Europe. Ne rajonin e Europes Juglindore, si sistemet e marredhenieve te punes ashtu edhe procedurat e zgjidhjes alternative te mosmarreveshjeve (ZAM) jane relativisht te reja dhe objekt i ndryshimeve ne fazen e tranzicionit te kalimit ne nje ekonomi tregu. Gjithesesi, sindikatat dhe shoqatat e punedhenesve jane te ndergjegjshme se perdorimi i mekanizmave autonome dhe vullnetare eshte ka shume rendesi per permiresimin dhe perspejtimin e zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune. Ne kete drejtim, nje veshtrim krahasues i mekanizmave te ZAM ne Europe dhe ne disa vende te rajonit te Ballkanit, mund t'u sherbeje ketyre te fundit per te kuptuar, per te pershtatur dhe per te zbatuar mekanizma te tille ne perputhje me nevojat e veta.

Procedurat e parandalimit dhe zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune synojne t'u vijne ne ndihme paleve te perfshira ne nje marredhenie pune, ne menyre qe te arrijne nje zgjidhje paqesore dhe vullnetare per mosmarreveshjet qe mund te lindin, pa iu drejtar gjykates dhe permes mirekuptimit ne vendin e punes, jashte kanaleve tradicionale te rretheve gjyqesore. Keto procedura te zgjidhjes se mosmarreveshjeve per gjithesisht per caktohen nga legjislacioni vendas. Meqenese nje nga piksynimet kryesore te procedurave te zgjidhjes se mosmarreveshjeve eshte inkurajimi i kontratave kolektive, egziston nje preference per marreveshje dypaleshe sa here qe ajo eshte e mundur. Procedurat mund te jene tri llojesh, perkatesisht: pajtimi, ndermjetesimi dhe arbitrimi; kur vendimi jepet nga nje gjykatë klasike apo *conseil de prud'hommes* (keshilli i te urteve), atehere ai behet procedure gjyqesore. E perbashketa e ketyre procedurave eshte natyra vullnetare e sistemit, kur palet zgjedhin ne favor te nje menyre zgjidhje apo te nje tjetre. Keto praktika, te cilave u referohemi si "mekanizma te zgjidhjes alternative te mosmarreveshjeve (ZAM)" jane te zbatueshme ne te gjitha llojet e mosmarreveshjeve. Ne disa raste ato shqyrtojne zbatimin dhe interpretimin e nje te drejte egzistuese, te ratifikuar ose jo nga ligji; marreveshjet kolektive dhe kontratat individuale.

Te ashtuquajturat "konflikte te se drejtes" trajtohen, se paku ne shumicen e 25 Shteteve anetare te BE-se nga juridikioni kombetar kompetent i punes, me perjashtim te Qipros ku Ministria e Punes i trajton te dyja llojet e mosmarreveshjeve.

Ato trajtojne, gjithashtu, konfliktet e interesit qe per gjithesisht lindin kur kontrata kolektive prishet. Per me teper, nje mosmarreveshje ne pune mund te kete te beje me nje punetor te vetem (mosmarreveshje individuale) ose me nje grup punetoresh (mosmarreveshje kolektive).

## Mekanizmat e zgjidhjes alternative te mosmarreveshjes: Nje veshtrim krahasues

Ne nivelin nerkombetar, ne ate European dhe kombetar te BE-se, mekanizmat ZAM mund te luajne nje rol te rendesishem, sikurse shihet edhe ne referencat e detauara me poshte.

Megjithate, zgjidhja e mosmarreveshjeve nerkombetare te punes ka nje resonance te vogel vepruese ne ceshtjet civile, krahasuar me fusha te tjera te ligjit civil sic eshte ligji komercial dhe ai i familjes. Disa mund te thone se sistemet nerkombetare te mosmarreveshjeve ne pune jane ende ne perpunim e siper. Perkundrazi, sistemet kombetare ZAM ne ceshtjet e punes, funksionojne mire e bukur ne te 15-te ish-shtetet anetare te BE-se. Sistemet e marredhenieve te punes ne 9 nga 10 shtetet e reja anetare te 15-s se BE-se, sikurse edhe ne disa vende te Europes Juglindore, jane ne procesin e miratimit dhe/ apo perpunimit te sistemeve te tilla ZAM ne periudhen e kalimit ne nje ekonomi tregu. Nje veshtrim krahasues i dispozitave dhe

sistemeve ZAM ne nje Europe te zgjeruar, do te ndihmoje per te qartesuar sfidat me te cilat perballen partneret sociale dhe shteti, nepermjet identifikimit te pengesave dhe gjetjes se zgjidhjeve te mundshme alternative per problemet kombetare.

## Veshtrim nderkombetar i ZAM

**Rekomandimi nr 92 i ILO-s** mbi pajtimin dhe arbitrimin vullnetar u miratua ne vitin 1951, njeherazi me rekomandimin 91 mbi marreveshjet kolektive. Ai percakton parimet baze te pajtimit dha arbitrimit dhe, persa i perket pajtimit, ILO rekomandon ngritjen e nje makinerie (sistemi) vullnetare pajtimi ne ndihme te parandalimit dhe zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune midis punedhenesve dhe punetoreve. Ky sistem i ngritur mbi nje baze te perbashket duhet te perfshire nje perfaqesim te barabarte te punedhenesve dhe punemarresve. Per me teper, procedura, duhet te jete falas dhe e shpejte, ajo duhet te vihet ne levizje ose me nismen e njeres prej paleve ne mosmarreveshje ose jashte zyrave (ex officio) nga autoriteti vullnetar i pajtimit, me miratimin e paleve te interesuara. Meqenese nje nga piksynimet qe ky system kerkon te arrije eshte zgjidhja jo-gjyqesore e mosmarreveshjeve (qofte permes pajtimit, ndermjetesimit apo arbitrimit), palet duhet te inkurajohen te mos ngrihen ne greve dhe te mos mbyllin ndermarrjet ne kohen e zhvillimit te procedures. Asnje dispozite e Rekomandimit nuk mund te kufizoje te drejten per greve. Se fundi, kur arrihet nje marreveshje, ajo duhet te behet me shkrim dhe te konsiderohet e barabarte me marreveshjen kolektive.

Gjithashtu, **Rekomandimi 163** mbi kontratat kolektive, miratuar ne vitin 1981 rekomandon qe, nese eshte e nevojshme duhet te merren masa per zgjidhjen e konflikteve ne pune, per t'i ardhur ne ndihme paleve qe kerkojne zgjidhje te mosmarreveshjeve, kur keto lindin gjate bisedimeve per marreveshje, lidhur me interpretimin ose zbatimin e marreveshjes, ose me (Rekomandimi 130) rastet individuale apo kolektive te ankesave ne vendin e punes.

Sipas ketij rekomandimi te fundit, cilido punetor, qe vepron individualisht apo kolektivisht, duhet te kete te drejte te depozitoje nje ankeze dhe ta paraqese ate per shqyrtim pa pesuar asgne lloj paragjykimi, cilidoqofte perfundimi.

Arsyet per ankimim mund te jene te cdo mase apo situate, qe ka te beje me marredheniet midis punedhenesit dhe punetorit, apo qe ndikon ose mund te ndikoje ne kushtet e punes te nje apo te disa punetoreve ne rastin kur ajo mase apo ajo situate bie ndesh me dispozitat e nje marreveshje kolektive te zbatueshme apo te nje kontrate individuale punesimi, me normat e punes, me ligjet ose rregulloret si edhe me zakonet apo perdonimin e nje dege profesionale te veprimtarise ekonomike apo te vendit.

Persa i perket konventes nr.87 mbi Lirine e Shoqatave dhe Mbrojtjen e se Drejtes per t'u Organizuar (te vitit 1948) dhe konventes nr.98 mbi te Drejten per t'u Organizuar dhe Kontraten Kolektive (te vitit 1949), rastet qe shqyrton Komiteti i Lirise se Shoqateve, ne vartesi te organit Qeverises te ILO-s, mbi kufizimet ne baze te parimit te kontratave te lira dhe vullnetare, rrallehere i referohen kufizimeve te perdonimit te nje procedure arbitrimi te detyrueshem. Psh. kur palet nuk arrijne mirekuptim me ane te kontrates kolektive, ato mund t'i drejtohen arbitrimit te detyrueshem vetem ne rastin e sherbimeve elementare ne kuptimin e ngushte te fjales, pra te sherbimeve ne te cilat nderprerja do te rrezikonte jeten, sigurine vetiake apo shendetin e te gjithe apo te nje pjese te popullsise (raporti 286, rastet 1648,1650). Ne disa sherbime dytesore, duhet t'i jepet perparesi kontrates kolektive, si mjet per rregullimin e kushteve te punes, dhe jo arbitrimit te detyrueshem (raporti 291, rasti 1680). Per me teper, dispozitat qe percaktojne se kur marreveshjet mes paleve deshtojne pikat e mosmarreveshjes

ne kontraten kolektive duhet te zgjidhen nga arbitrimi i autoritetit, nuk jane ne perputhje me parimet e bisedimeve vullnetare qe perfshihen ne konventen 98 (raporti 259, rasti 1450). Vec kesaj, cdo dispozite qe lejon palet te kerkjone ne menyre te njeaneshme nderhyrjen e autoritetit te punes per te rregulluar mosmarreveshjet, mund te minoje ndjeshem te drejten e punetoreve per greve dhe nuk nxit lidhjen e kontrates kolektive vullnetare (raporti 265, rastet 1478, 1484).

**Karta sociale Europiane** e vitit 1961, rishikuar me 1966, eshte nje tekst solemn nderkombetar te cilin te gjitha shtetet ratifikuese jane angazhuar ta zbatojne. Ne Maj 2004, nje numer prej 44 vendesh e nenshkroi Karten (10 vende e kishin nenshkruar ne vitin 1961 dhe 34 vende e kishin rishikuar ne vitin 1996), ndersa 34 vende e kishin ratifikuar ate. Ndermjet vendeve te Europees JugLindore, Shqiperia, Bullgaria, Kroacia, Moldavia dhe Rumania e kishin nenshkruar dhe ratifikuar Karten, ndersa FYROM dhe Bosnje-Hercegovina vetem e kishin nenshkruar. Karta percaktonte nje numer te drejtash dhe lirish social-ekonomike dhe vendoste sistemin e kontrollit per te garantuar respektimin e ketyre te drejtave nga shtetet nenshkruesse.

Ne perputhje me Nenin 6 paragrafi 3 te Kartes sociale Europiane mbi te drejten per kontrate kolektive dhe “me qellim qe te sigurohet zbatimi efikas i te drejtes per kontrate kolektive, Palet bien dakord qe:

1. te nxisin konsultimet e perbashketa midis punedhenesve dhe punetoreve;
2. t'i japid shtyse, aty ku eshte e mundur dhe e udhes, ngritjes se nje sistemi per **bisedime vullnetare** midis punedhenesve apo organizatave te punedhenesve dhe organizatave te punetoreve, me qellim rregullimin e kushteve te punesimit me ane te marreveshjeve kolektive;
3. **t'i japid shtyse ngritjes dhe funksionimit te nje sistemi te pershatshem per pajtimin dhe arbitrimin vullnetar, me qellim rregullimin e mosmarreveshjeve;** si edhe te njohin:
4. te drejten e punetoreve dhe te punedhenesve per veprime kolektive ne raste te konfliktit te interesave, perfshi te drejten per greve, ne funksion te detyrimeve qe lindin nga marreveshjet kolektive te lidhura paraprakisht”.

Zbatimi i angazhimeve te percaktuara ne Karte kontrollohet nga Komiteti European per te Drejta Sociale, ma ane te dy procedurave te vecanta:

- 1) nje procedure kontrolli mbi bazen e raporteve vjetore kombetare te hartuara nga shtetet. Pas shqyrimit te rapportit, Komiteti publikon konkluzionet ku vendos per pajtueshmerine, apo ne te kundert per situatat kombetare, qe kane te bejne me Karten. Nese Shteti nuk ndjek nje vendim mospajtueshmerie njoftuar nga Komiteti, atehere Komiteti i Ministrave i dergon ketij shteti nje rekomandim dhe i kerkon te ndryshoje situaten *de jure* ose *de facto*.

Puna e Komitetit te Ministrave perqatitet nga nje Komitet Qeveritar i perbere nga perfaquesues te pales se Qeverive nenshkruese te Kartes, ne ndihme te te cileve jane vezhgues qe perfaquesojne partneret sociale Europiane. Ky Komitet shqyrton vendimin e mospajtueshmerise ne muajt pas botimit dhe njoftimit. Shteti i interesuar duhet te njoftoje per masat qe ka marre, apo qe synon te marre per te korigjuar situaten dhe ne kete rast, ai duhet te percaktoje afatet per arritjen e pajtueshmerise.

Ne rastet kur Komiteti Qeveritar mendon se jane ndermarre hapat e duhur per te vene ne vend nje shkelje dhe per te leshuar nje vendim mos-pajtueshmerie, ai mund t'i propozoj Komitetit te Ministrave qe t'i dergoje nje rekomandim shtetit te interesuar.

Nje rekomandim i tille kerkon qe Shteti te marre masa per te korigjuar situaten.

Cdo vit, Komiteti Qeveritar i paraqet nje raport Komitetit te Ministrave. Qysh prej vitit 2002, ai paraqet nje raport mbi Karten Sociale te rishikuar si edhe nje raport mbi Karten e vitit 1961.

- 2) Nje procedure te ankesave, qe i jep mundesi organizatave te njohura<sup>1</sup> t'i paraqesin Komitetit European per te Drejta Sociale pretendimet e tyre lidhur me shkeljet e Kartes.

Se fundi, vetem 12 vende, perfshi Bullgarine dhe Kroacine, kane rene dakord te perdonin procedurat e ankesave kolektive. Ne praktike, mekanizmat e kontrollit te ngritura nga Karta kane ndikuar qe shtetet te miratojne ndryshimet ne ligj ose ne praktike, ne menyre qe kushtet te jene ne perputhje me Karten.

## ZAM ne Bashkimin European<sup>2</sup>

Keshilli European i Bashkimit European ka perpiluar nje Karte te te drejtave themelore (OJEC C 364 ne 18/12/2000 dhe OJEC C 007/8 ne 11/01/2001), qellimi i se ciles eshte “te hartoje nje Karte te te drejtave themelore ne menyre qe rendesia dhe domozdoshmeria e tyre te behet me e kapshme dhe me e prekshme per qytetaret e BE-se”. Miratimi i Kartes, para se gjithash, eshte nje mesazh politik i Pesembedhjetshes per qytetaret e Europe. Te drejtat ekonomike dhe sociale qe permban Karta jane ato qe perfshihen ne Karten e Komunitetit te te drejtave sociale per punetoret, miratuar me 1989, neni 13 i te cilit shprehej qe, per te lethesuar zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune, ka shume rendesi te inkurajohet perfshirja dhe perdonimi i procedurave te ndermjetesimit dhe arbitrimit, ne perputhje me praktikat e vendit dhe ne nivelet e duhura.

Gjithesesi, dimensioni nderkombetar i sistemit te zgjidhjes se konflikteve eshte nje ceshtje qe kerkon si angazhimin e organizmave nderkombetare ashtu edhe atyre Europiane. Eshte per tu theksuar qe ndersa procedurat ZAM ne fushen e ligjit civil dhe komercial jane objekt i nje interesimi te madh dhe perpunimi te vazdueshem, per problemet e punes keto iniciativa kane munguar dukshem deri kohet e fundit. Nderkohe, Gjykata e Perhershme e Arbitritimit ka nisur diskutimet mbi efektivitetin dhe mundesine e nje sistemi alternativ per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune ne nivel nderkombetar duke krijuar apo pershtatur ligje nderkombetare per zgjidhjen e mosmarreveshjeve nderkombetare ne pune.

Ne nivel European, ne fazen e pare, ne mes te viteve '90 u shfaq i njejti interes per ligjin e mbrojtjes se konsumatorit dhe familjes. Qe prej vitit 2000, Komisioni European ka nisur

---

<sup>1</sup> Konfederata e Sindikatave Europiane, UNICE dhe ILO; organizatat jo-qeveritare (OJQ-te) me status konsultativ ne Keshillin e Europeve dhe te regjistruara ne nje liste te hartuar per kete qellim nga Komiteti Qeveritar; organizatat e punemarresve dhe sindikatave te shtetit ne fjale; dhe, per shtetet te cilat, vec kesaj, e pranojne kete mundesi, OJQ-te vendase.

<sup>2</sup> Schömann, I. (2002) Alternative dispute resolution mechanisms in labour issues: towards an EU mechanism? ETUI TRANSFER 4/2002 pages 701-707.

keshillimet dhe studimet mbi rritjen e dobise se nje sistemi European te ZAM-it per zgjidhjen e mosmarreveshjet kolektive ne pune. Mekanizmat Europiane te procedurave jo-gjyqesore, si mekanizma plotesuese per sistemet kombetare ZAM, mund te japid nje mbeshtetje te cmuar per zhvillimin e dialogut social ne Europe dhe me gjere, per zhvillimin e sistemit European te marredhenieve ne pune.

Komisioni European DG i Drejtesise dhe i Puneve te Brendshme, ne programin e punes legiislative per vitin 2004,ne muajin shtator te ketij viti, parashikoi miratimin e nje Projekt-Direktive mbi Metodat Alternative te Zgjidhjes se Mosmarreveshjeve mbi ceshtjet civile- jo mbi ato te punes- bazuar ne Traktatin e Komunitetit, Neni 61/c mbi bashke-vendimin. Qellimi i kesaj Projekt-Direktive eshte vendosja e nje instrumenti rregullator per percaktimin e standarteve minimum,ne menyre qe te sigurohet cilesia e proceseve ZAM dhe te garantohet pajtueshmeria e tyre me procedurat gjyqesore. Kjo do t'u jape mundesi te gjithe paditesve civile te perdonin skemat e besueshme dhe efikase te Zgjidhjes Alternative te Mosmarreveshjeve. Ky instrument do te synoje te krijoje nje ekuilibre te drejte midis ketyre dy objektivave: te siguroje cilesine e proceseve ZAM si edhe pajtueshmerine e tyre me procedurat gjyqesore, duke ruajtur ne te njejten kohe elasticitetin e tyre.

### **ZAM ne Shtetet Anetare te BE: nje metode e mire-percaktuar e drejtesise private ne Europe**

Procedurat e zgjidhjes alternative te mosmarreveshjeve jane perhapur gjeresisht ne te 25 Shtetet Anetare te BE-se. Ne ish 15 shtetet anetare te BE edhe ne Qipro kjo ka ardhur si pasoje e pranimit gradual dhe e konsolidimit te kultures se maredhenieve ne pune, qe i japin perparesi bashkerendimit dhe bashkepunimit kundrejt konflikteve. Kurse ne pjesen me te madhe te shteteve te reja anetare te BE, si psh, ne Republiken Ceke, ne Estoni, Hungari, Poloni, Sllovaki dhe Slloveni procedurat ZAM ne ligjin e punes u bene te njobura ne fillim te viteve '90, ndersa ne Lituani, Letoni dhe Malte –ne fillim te viteve 2000.

Objktivi final i procedurave te ZAM eshte arritura e paqes ne pune. Ne kete drejtim, ZAM jane te lidhura ngushte me strukturen dhe respektimin e kontrates kolektive nga nje vend anetar, por edhe me sindikatat dhe shoqatat e punedhenesve, me te drejtat e punetoreve per informim dhe keshillim, qe duhen konsideruar si nje mekanizem i zgjidhjes paraprake (ex ante) te mosmarreveshjeve. Nese kontrata kolektive eshte niveli i pare dhe me i afert e nje mjedisi institucional ne te cilin zhvillohen dhe funksionojne procedurat ZAM, keto te fundit krijojn kushte per dialog dhe ofrojne mundesi te tjera per te arritur mirekuptim ne rastet kur konfliktet lindin ose nga permbajtja e ligjit ose gjate zbatimit te tij. Si te tilla, lehtesirat qe krijon ZAM, e forcojne dialogun social. Procedurat ZAM, shpesht te percaktuara dhe te rregulluara nga instrumente te bazuar ne kontrate, si rregull, administrohen nga organizma dy ose tri-palesh, ne te cilat partneret sociale luajne nje rol paresor, si ne rastin e kontratave kolektive.

Kur proceset e kontrates kolektive inkurajohen, per rrjedhoje rritet edhe pranimi social i procedurave te ndermjetesimit dhe pajtimit si zgjidhje autonome dhe vullnetare e mosmarreveshjeve ne pune. Per kete arsy, ZAM mund te konsiderohen si nje shtrirje/zjerim i kontrates kolektive.

Mekanizmat alternative per percaktimin dhe zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune, qofshin keto individuale apo kolektive, jane nje tipar i zakonshem dhe i mirepercaktuar ne pjesen me te madhe te sistemeve te marredhenieve ne pune ne shtetet anetare. Duke qene forme e drejtesise private, rrenjet e tyre shtrihen si ne sistemet konsensual te marredhenieve ne pune, ne rastet e vendeve Nordike, ashtu edhe ne sisteme me te institucionalizuara dhe te bazuara ne gjykata, si psh.ne France apo ne Spanje. Zhvillimi i hershem i procedurave alternative qe plotesojne mundesite/rruget gjyqesore brenda sistemeve kombetare te marredhenieve ne pune, tregon deshiren per te inkurajuar, se paku ne fazen paraprake, zgjidhje konsensual ne trajtimin e mosmarreveshjeve. Epersite e nenkuptuara te procedurave ZAM jane,gjithashtu, elasticiteti dhe shpejtësia e procedurave alternative, gjetja e zgjidhjeve me te pershatshme ne saje te njohurive dhe pervojes se pales se trete, qe merr pjese ne procedurat e ndermjetesimit dhe keshillimit; pavaresia si edhe shpenzimet e kufizuara te procedurave ZAM krahasuar me procedurat gjyqesore.

Ne procedurat ZAM, dallojme dy modele te mbrojtjes gjyqesore. Procedurat ZAM mund te perkufizohen si teknika ndihmese, qe duhen konsideruar si pjese e aktivitetit te gjykatave.

Ne kete rast, procedurat ZAM shpesh shkrihen ne nje alternative,qe gjithesesi eshte kontradiktore. Ndryshe, procedurat ZAM perkufizohen si skenare me nje fund te hapur dhe te pavarur/autonom, qe u japid mundesi paleve ne mosmarreveshje te perzgjedhin mes disa mundesive. Ne kete rast, ZAM konsiderohet si nje procedure plotesuese.Per me teper, menyra se si organizohet mbrojtja gjyqesore mund te inkurajoje perdorimin e ZAM ose te veproje si nje faktor jo-nxites. Tipare te rendesishme jane psh.egzistenza ose jo, e sherbimeve te vecanta gjyqesore lidhur me ceshtjet e punes brenda juridiksonit, si edhe struktura dhe perberja e gjykateve te punes apo e gjykatave te tjera qe kane juridikcion mbi mosmarreveshjet ne pune.

Roli i pales se trete ne procedure pasqyrin shkallen e mirekuptimit mes paleve. Shkalla e nderhyrjes se pales se trete eshte ajo qe percakton tri menyrat e ndryshme te veprimit (*modi operandi*). Sipas perkufizimit te propozuar nga Komisioni European, **pajtimi** i referohet nje procesi ku nje pale e trete e pavarur u vjen ne ndihme paleve ne mosmarreveshje qe te gjejne nje zgjidhje. **Ndermjetesimi** i referohet procesit te lartpermendor sipas te cilit pala e trete luan nje rol aktiv ne gjetjen e zgjidhjeve dhe sugjerimin qe u ben paleve lidhur me keto zgjidhje. Gjithesesi, ne disa shtete anetare te BE nuk behet dallim midis pajtimit dhe ndermjetesimit, sic ndodh ne Malte per shembull.

Nese pajtimi rezulton pa sukses,palet ne mosmarreveshje mund t'i drejtohen arbitrimi. **Arbitrimi** ndryshon nga pajtimi dhe ndermjetesimi, sepse ne kete rast ai ia kalon perjegjesine pales se trete, qe te vendose per kushtet ne te cilat duhet te zgjidhet mosmarreveshja. Arbitrimi mund te jete i detyrueshem ose vullnetar. Procedurat e pajtimit dhe ndermjetesimit jane tipare te zakonshme te peisazhit European dhe perdoren shpesh per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune. Ndersa arbitrimi luan nje rol shume me te kufizuar ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve. Pergjithesisht, arbitrimi eshte vullnetar dhe si rregull perdoret si nje mjet i fundit, pasi kane deshtuar bisedimet per zgjidhjen e konfliktit. Arbitrimi eshte i huaj per sisteme te caktuara kombetare (psh. ne Estoni) dhe hapesirat e mirekuptimit, sipas te cilave palet ne nje marreveshje bien dakord t'i drejtohen arbitrimi per cdo mosmarreveshje qe mund te linde mes tyre, pra para se te ndodhe mosmarreveshja, jane te ndaluara ne disa sisteme.

## Karakteristikat te perbashketa te procedurave kombetare ZAM ne Shtetet Anetare te BE

Ndonse procedurat ZAM ndryshojne nga nje Shtet Anetar i BE-se ne nje tjeter, ato gjithesesi kane karakteristika te perbashketa. Psh. perdomimi i procedurave jashtligjore per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune, si rregull nuk perjashton faktin qe palet t'i drejtohen gjykatave.

Vec kesaj, ne pjesen me te madhe te sistemeve ZAM, procedurat e ndermjetesimit, pajtimit dhe arbitrimit nuk varen nga njera tjetra, keshtu qe palet ne nje konflikt pune mund te ndermarrin nje proces arbitrimi pavaresisht nga perdomimi i procedurave te ndermjetesimit dhe/ose te pajtimit. Ndonese procedurat ZAM jane pak a shume te formalizuara, zakonisht ato nuk jane te standartizuara dhe, per kete arsy, u lene liri veprimi paleve per t'i vete-rregulluar ato.

Gjithashtu, procedurat jo-gjyqesore mund te jene fakultative ose te detyrueshme ne vartesi te natyres se mosmarreveshjes. Psh. ne Suedi keshillimi eshte nje procedure paraprake e detyrueshme ne rastet kur ka rrezik te ndodhin veprime rebeluese si: protesta, greva etj.

Roli i pales se trete ne procedurat ZAM paraqet disa ngjashmeri interesante. Nese pajtimi, ndermjetesimi dhe arbitrimi kryhen nga nje individ ose nga nje organizem kolegjial dy-apo-tri palesh, ose si ne France, nga nje gjykate e perbere nga gjyqtare jo profesioniste, kjo pale e trete shfaq karakteristika te njejtë - te tilla si pavaresia dhe paanshmeria. Palet ne nje mosmarreveshje/konflikt duhet te kene pavaresi ne zgjedhjen e pales se trete. Per me teper, ato duhet te kene mundesine e konkurimit te pales se trete ne rast te humbjes se besimit ne aftesine e tyre per te permbushur rolin e ndermjetesuesit apo te pajtuesit.

Pavaresisht se kultura e arbitrimit eshte e mirepercaktuar ne shtetet anetare te BE, gjithesesi natyra e propozimeve te hartuara nga ndermjetesuesit dhe pajtuesit nuk varion dukshem nga nje shtet anetar ne nje tjeter. Per me shume, zbatimi i vendimit te ndermjetesimit ose pajtimit, apo te nje vendimi arbitrimi karakterizohet nga territorialiteti i vet (kufizimi ne nje shtet te vetem anetar) dhe mund te hase veshtiresi ne rastet e e zgjidhjes se mosmarreveshjeve nderkombetare ne pune.

Efekti detyrues i vendimeve per ndermjetesim ose pajtim ne nivel kombetar mund te varioje nga nje deklarate qellimi me autoritet moral, ne nje rezultat te njejtë me marreveshjen kolektive; ne rastin e arbitrimit, vendimet kundershtohen vetem prane nje agjencie gjyqesore ose ne gjykate.

Ne pjesen me te madhe te Shteteve Anetare, si rregull propozimet nuk jane te detyrueshme per palet ne mosmarreveshje/konflikt. Gjithesesi, rekomandimet e leshuara nga ndermjetesuesit apo pajtuesit- vecanerisht ne rastin e nje organizmi kolegjial - kane autoritet moral me te madh, i cili rritet akoma me shume kur vendimi behet publik. Zakonisht, palet ne nje mosmarreveshje/konflikt pune e pranojne propozimin e organizmit ndermjetesues ose pajtues. Psh. ne Danimarke, keshilli i punetoreve duhet ta pranoje ose ta refuzoje zyrtarisht vendimin.

Gjate fazes se ndermjetesimit dhe pajtimit, mund te arrihet mirekuptim, i cili per gjithesisht ka karakterin detyrues te marreveshjes se percaktuar nga ligji civil ose te marreveshjes kolektive te percaktuar nga ligji i punes kolektive. Natyra e nje marreveshje varet gjithashtu nga natyra

private ose administrative e organizmit ndermjetesues ose pajtues, qe jep mendime ose vendime.Ne Austri, psh vendimi i agjencise administrative pajtuese konsiderohet si akt zyrtar administrativ dhe jo si marreveshje. Ne cdo rast, paleve duhet t'u jepet mundesia te kundershtojne ne nje shkalle me te larte cdo vendim ndermjetesues ose pajtues. Gjithashtu, mundesia e perdonimit te procedurave gjyqesore duhet te sigurohet ne te gjitha fazat e nje procedure ndermjetesimi dhe pajtimi.

## Kufizimet e sistemeve ZAM: territorialiteti i vendimeve ZAM

Pyetja qe shtrohet eshte nese nje vendim ndermjetesimi apo pajtimi mund te zbatohet pertej kufinjve kombetare. Per pjesen me te madhe te ceshtjeve, territorialiteti i procedurave ndermjetesuese dhe pajtuese eshte karakteristike e perbashket ne shtetet anetare te BE-se. Ketu nuk ka asgje per t'u kritikuar, por ne fakt ai vends os nje kufi te rendesishem per njohjen dhe zbatimin e vendimeve te ndermjetesimit dhe konsultimit ne konfliktet nerkombetare te punes ne nje shtet tjeter anetar te BE-se.

## ZAM ne vendet e Europees JugLindore

Informacioni qe permban ky kapitull eshte perqatitur nga anetaret e rrjetit te ETUI-t per Ballkanin, raporti bullgar nga Velitchka Mikovas (KNSB) dhe rapporti kombetar rumun nga Lucian Vasilescu (CNSLR Fratia). Informacioni shtese eshte marre nga rapporti nr 78 i ETUI-t<sup>3</sup>. Ne legjislacionin e punes te Europees Juglindore, metodat e zgjidhjes paqesore te mosmarreveshjeve kolektive ne pune jane: **ndermjetesimi**, si ne **Bulgari** dhe **Rumani**; **pajtimi**, si ne **Bosnie-Hercegovine, Bullgari, Kroaci** dhe **Rumani**; dhe **arbitrimi**, si ne **Bosnie-Hercegovine, Bullgari, Maqedoni** dhe **Rumani**.

Keto faza te ndryshme te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune kryesisht percaktohen me ligj, ndersa perdonimi i tyre ndryshon sipas situatave te vecanta ne nje rend te vecante.

Ligji **Rumun** i punes (1999) percakton se pajtimi dhe arbitrimi jane te detyrueshem dhe duhet te ndihmojne per te zgjidhur ato mosmarreveshje qe kane karakter kolektiv. Organizmi publik pajtues dhe ndermjetesues eshte Ministria e Punes,Solidaritetit Social dhe Familjes.Perberja e ketij organizmi pajtues dhe arbitrues eshte tri-paleshe.

Brenda dhjete diteve nga komunikimi i ankesave dhe pretendimeve te paleve, i derguari i Ministrise cakton nje procedure te detyrueshme ndermjetesimi. Nese pajtimi deshton, gje qe sipas raportit kombetar ndodh shpesh,atehere mblidhet Komiteti i Arbitrimit.Komiteti jep vendimin 10 dite nga data e mbledhjes. Ky vendim mund te mos rrezohet dhe eleminon te gjitha mundesite per greve. Ka pak mundesi qe ky tipar i fundit te inkurajoje sindikatat qe t'i drejtohen metodes se arbitrimit.

Ne **Bulgari**, ne vitin 1997 u krijua nje organizem kombetar, Institut Kombetar per Pajtim dhe Arbitrim nen vartesine e Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale, me qellim mbikqyrjen e metodave te pajtimit dhe arbitrimit.Ai bazohet ne nje perfaqesim tri-palesh, megjithate nuk funksionon sic duhet. Ne vitin 2001 ky organizem kombetar vullnetar i

---

<sup>3</sup> Shiko gjithashtu Duvel.W, Schomann.I, Clauwaer.S dhe Gradev.G (2003): *Marredheniet e punes ne Europen JugLindore – nje veshtrim ligor ne 200,3* Raporti i ETUI-t nr 78.

ndermjetesimit dhe pajtimit u riorganizua dhe tashme ai trajton mosmarreveshjet kolektive ne pune.

Ai ka statusin e nje personi te moralshem te lidhur me Ministrine e Punes. Organizmi perbehet nga nje keshill mbikqyres, qellimi i te cilit eshte te siguroje besueshmerine dhe te beje publik listat e pajtuesve dhe arbitruesve te perzgjedhur nga sindikatat dhe punedhenesit. Te gjitha palet ne mosmarreveshje mund t'i drejtohen ketij organi ne perpjekjet e tyre per ta zgjidhur mosmarreveshjen jashte dyerve te gjykates.

Ne kete menyre, shkembimet mes paleve behen me te lehta. Sapo caktohet pajtuesi, paleve u lihet dy jave kohe (qe mund te zgjatet me kerkese te perbashket) ose qe te gjejne zgjdhje per mosmarreveshjet, ose per t'ju drejtar arbitrimit ne rast se nuk bien dakord. Ne te kundert, mosmarreveshja protokollohet dhe nuk ndermerret asnje forme e metejshme ndermjetesimi.

Arbitrimi ne parim eshte vullnetar, pervecse ne rastet kur siguron nje sherbim publik minimum gjate nje greve kur arbitrimi eshte i detyrueshem. Arbitrimi mund te kerkohet nga njera prej paleve ne mosmarreveshje, por si rregull kerkohet arrija e nje mirekuptimi midis dy paleve qe i drejtohen kesaj procedure. Paleve u kerkohet te pranojne vendimin e arbitrimit, por me ligj nuk detyrohen per asnje ndeshkim/sanksion ne mungese te respektimit te vendimit. Raporti nenvizon qe ne nje rast te tille, punetoret mund te organizohen ligjerisht ne greve, si mjet i fundit i presionit per te zgjidhur mosmarreveshjen midis tyre dhe punedhenesit (me perjashtim te sektoreve te energjise, komunikacionit dhe shendetise). Bullgaria ka marre nje kerkese nga ILO qe te ndryshoje legjisacionin duke hequr detyrimin per kufizimin e kohezgjatjes se greves si edhe dhenien e garancive per kompensim per sektoret ne te cilet e drejta per greve eshte e kufizuar.

Si ne **Bosnje-Hercegovine** ashtu edhe ne **Kroaci**, egziston nje keshill pajtues, me anetare nga partneret sociale dhe eksperte te pavarur te emeruar nga lista e perpiluar nga Ministria e Punes (ne Bosnje-Hercegovine) apo nga Keshilli Social Ekonomik (ne Kroaci), i cili perqjigjet per gjetjen e nje zgjdhje paqesore. Bosnje-Hercegovina ka te njejtten strukture arbitrimi.

Kur ne **Maqedoni**, organizmi qeverises i ngarkuar me ceshtjet e punes gjykon se, gjate regjistrimit te marreveshjeve te perqjithshme apo te degeve, ka dispozita te vecanta te marreveshjes kolektive qe bien ndesh me ligjin ose me marreveshjen e perqjithshme kolektive, ne kete rast duhen njoftuar nenshkruesit e marreveshjes dhe duhen percaktuar kushtet e pajtimit. Kur neneshkruesit e marreveshjes kolektive nuk arrijne t'i menjanojne keto dispozita te paperfonduara brenda afatit te caktuar, atehere organizmi qeverises ndermerr veprime llore ne gjykaten perkatese. Nese mosmarreveshjet kane te bejne me marreveshjet kolektive, ceshtjet ne fjale zgjidhen nga nje komitet i posacem arbitrimi.

Duke iu referuar pjeses me te madhe te raporteve, verejme se procedurat e zgjdhjes alternative te mosmarreveshjeve perdoren shume ralle; palet e kane te veshtire te bien dakord per zgjedhjen e nje ndermjetesuesi, kurse ne rastet e arbitrimit palet nuk kane besim tek komisioni i arbitrimit (**Rumani**). Ne **Kroaci**, lista e pajtuesve as nuk u verifikua, as nuk u publikua. Mungesa e tradites ne perdonimin e zgjidhjeve vullnetare fakultative per mosmarreveshjet ne pune, shpjegon gjithashtu edhe ngurimin per t'iu drejtar procedurave alternative (**Bulgari**).

Pamundesia per apel eshte nje faktor tjeter shkurajues qe shpjegon shperfilljen e procedures se arbitrimit ne **Bosnie-Hercegovine**. Ne raportin e **Kosoves**, as nuk behet fjale per ndermjetesim, pajtim apo arbitrim por palet ne nje mosmarreveshje kolektive mund te kerkojne zgjidhje nga inspektoriati i punes.

Ne **Shqiperi**,tani per tani, Kodi i Punes nuk parashikon perdonimin e mekanizmave ZAM. Megjithate sindikatat shpresojne te perfshihen ne bisedime tri-paleshe per te prezantuar sisteme te tilla vullnetare te zgjidhjes se mosmarreveshjeve. Informacioni kombetar vinte theksin ne nevojen e trajnimit te te gjitha paleve te angazhuara ne problemet e ndermjetesimit, pajtimit dhe arbitrimit, si edhe te gjykatesve profesioniste - mbi legjislacionin kombetar te punes, dhe vecanerisht mbi metodat dhe procedurat e dialogut social; mbi dispozitat nderkombetare dhe Europiane te ZAM dhe mbi gjykatat e punes.

Raporti gjithashtu theksonte nevojen per informacion procedural dhe transparence te sistemeve ZAM, si edhe domozdoshmerine e pavaresise gjyqesore te organeve te pajtimit dhe ndermjetesimit.

## **Konkluzione**

Zgjidhja jo-gjyqesore e mosmarreveshjeve eshte nje tipar kryesor i mjedisit te marredhenieve te punes ne Europe. Mekanizmat ZAM kane zene shtrat ne kulturen sociale dhe ligjore te te gjitha shteteve anetare dhe jane zhvilluar brenda nje periudhe te gjate kohe. Keto sisteme alternative dhe funksionale te procedurave te zgjidhjes se mosmarreveshje/konflikteve ne pune dallohen nga struktura dhe organizimi krejt i vecante qe ato kane si edhe nga karakteri detyrues ose jo-detyrues i rezultatit te tyre. Por tipari me i rendesishem i ZAM eshte gatishmeria e paleve per te perdonur mekanizma te ndryshme mirekuptimi. Pranimi social i ZAM vjen si rezultat i vertetesise dhe konsolidimit progresiv te kultures se maredhenieve ne pune te bazuar ne dialogun social.

E kunderta ndodh ne vendet e Ballkanit, te cilet kane nje perdonim te kufizuar te ZAM, ose per shkak se ligji percakton nje sistem pajtimi dhe/ose arbitrimi qe karakterizohet nga mungesa e transparences dhe efikasitetit, ose per shkak se sistemet e kontrates kolektive qe po rishikohen nuk guxojne t'u drejtohen sistemeve vullnetare te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune, bazuar ne besimin e ndersjelle midis paleve dhe ne respektimin e procedurave dhe vendimeve. Karakteri detyrues i procedurave te caktuara te pajtimit dhe/ose arbitrimit, shkakton nje problem vertet serioz,qe eshte kufizimi dhe dje madje heqja e te drejtes per greve.

Se fundi, ne pjesen me te madhe te vendeve te Ballkanit, Shteti luan nje rol mjaft te madh ne rregullimin e konflikteve kolektive ne pune, pa marre parasysh faktin se nepermjet pajtimit dhe ndermjetesimit synohet qe te dyja palet te kerkojne zgjidhje ne menyre me te pavarur.

**Veshtrim kahasues mbi pajtimin, ndermjetesimin, arbitrimin**

## **Pasqyra**

### 1) Austri

<b>Metoda</b>	Ndermjetesim
<b>Organizmi</b>	<b>Bordi Federal i Arbitrimit</b>
Brenda	Ministrise Federale te Punes dhe Çeshtjeve Sociale
Perberja	Punedhenes + punemarres
Subjekti	Marreveshjet e reja kolektive + plotesimet(ndryshimet)
Detyra	Te ndermjетesoje dhe inkurajoje zgjidhje
<b>Rezultati</b>	Me shkrim- si një marreveshje kolektive Vendimet Jane te kushteuara nga pranimi paraprak
<b>Organizmi</b>	<b>Bordet e Ndermjetesimit</b>
Brenda	Gjykatave te punes
Subjekti	Pershatja e rregullave te brendshme te ndermarrjes
Detyra	Te ndermjетesoje + inkurajoje zgjidhje + mund te shpalle vendime

### 2) Belgjike

<b>Metoda</b>	Pajtim
<b>Organizmi</b>	<b>Komisioni i Perbashket i Menazhimit te Punes</b>
Subjekti	Parandalim ose pajtim i te gjitha mosmarreveshjeve midis punedhenesve dhe punetoreve
Anetaret	Anetare te sindikatave + anetare te punedhenesve
<b>Organizmi</b>	<b>Pajtues qeveritare</b>
Emerimi	11 anetare te emeruar nga Kurora
Qellimi	Te perpiqet te parandaloje zgjidhjen e mosmarreveshjeve dhe ndjeke lindjen, zhvillimin dhe perfundimin e mosmarreveshjeve te tilla Te vazhdoje te gjitha bisedimet per pajtimin e paleve Te jete ne kontakt te perhershëm me organizatat e punes dhe me shoqatat e punedhenesve

### 3) Republika Çeke

<b>Metoda</b>	Ndermjetesim – vullnetar
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjetesuesi</b>
Subjekti	Mosmarreveshjet kolektive mbi perfundimin e marreveshjeve kolektive dhe mbi permbyshjen e detyrimeve te marreveshjes kolektive
Anetaret	Nje person nga lista e ndermjetesuesve qe disponon Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale ose nje person per te cilin kane rene dakord palet dhe qe ploteson kritere te caktuara
Qellimi	Ben nje propozim me shkrim mbi bazen e diskutimeve me palet kontraktuese
<b>Metoda</b>	Arbitrim
<b>Organizmi</b>	<b>Arbitruesi</b>
	Lista e arbitruesit mbahet nga e njejtë Ministri
Qellimi	Nxjerr nje vendim

#### 4) Danimarka

<b>Metoda</b>	Pajtim
<b>Organizmi</b>	<b>Bordi i Pajtimit</b>
Anetare	3 perfaquesues nga DA dhe LO
Emerimi	Ministria e Punësimit per tre vjet me rekomandimin e gjykates se punës
Qellimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Te nxise bashkepunimin midis drejtuesve dhe punemarresve dhe te ndihmoje ne krijimin dhe funksionimin e komiteve te bashkepunimit</li> <li>Te zgjidhe mosmarreveshjet qe lindin nga zbatimi dhe interpretimi i marreveshjeve kolektive</li> </ul>
Kerkesa	Ose nje nga palet ose kur mosmarreveshja gjykohet se ka rendesi kombetare

#### 5) Estoni

<b>Metoda</b>	Pajtim
<b>Organizmi</b>	<b>Komisioni i Mosmarreveshjeve ne Pune</b> (ne 15 vende)
Anetare	Kryetari (punemarres i inspektoriatit lokal te punës) + numer te barabarte te perfaquesuesve te punemarresve dhe punedhenesve
<b>Organizmi</b>	<b>Pajtues Publik/Lokal</b>
Qellimi	Te zgjidhe mosmarreveshjet kolektive ne pune

#### 6) Finlande

<b>Metoda</b>	Ndermjetesim + Pajtim + Arbitrim
Vullnetar/ detyrues	<ul style="list-style-type: none"> <li>Greva mund te nise vetem kur pajtuesi kombetar njoftohet me shkrim dy jave perpara</li> <li>Arbitrim nese parashikohet ne marreveshjet kolektive</li> </ul>
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjetesuesi kombetar</b>
Qellimi	Te gjeje nje kompromis Mund te perpunoje nje zgjidhje
<b>Organizmi</b>	<b>Tribunalet e Arbitrimit</b>
Vullnetar/ detyrues	Me marreveshjen e paleve
Anetare	Tre vete – nje i emeruar nga secila pale + nje kryetar, qe zgjidhet nga dy te tjeret
<b>Statusi ligjor</b>	Vendimet jane perfundimtare + ligjerisht detyruese

#### 7) France

<b>Metoda</b>	Shume marreveshje kolektive ne nivel industrial parashikojne ngritjen e nje komiteti te perhershëm pajtimi
---------------	--

#### 8) Gjermani

<b>Metoda</b>	Pajtim sikurse parashikohet ne marreveshjet kolektive midis partnereve sociale
---------------	--

## 9) Greqi

<b>Metoda</b>	Ndermjetesim + arbitrim
Vullnetar/i detyrueshem	
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjetesim</b>
Qellimi	Kur bisedimet deshtojne
Emerimi	
Perzgjedhja	Palet jane te lira te zgjedhin nje ndermjetesues, nese ai nuk eshte perzgjedhur nga lista e hartuar cdo tre vjet nga sherbimi i ndermjetesimit + arbitrimit
Procedura	20 dite per arritjen e nje marreveshje. Kur ajo deshton, ndermjetesuesi paraqet propozimin e vet. Nese nuk pranohet, kalon ne arbitrim.
<b>Efekti Ligjor</b>	Propozimi i nenshkruar ka statusin e marreveshjes kolektive
<b>Organizmi</b>	<p><b>Arbitrim nese:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrihet nje marreveshje e perbashket midis dy paleve gjate procesit te kontrates kolektive</li> <li>• Me nismen e njeres pale, ne rastet kur pala tjeter e ka refuzuar ndermjetesimin</li> <li>• Me nismen e organizatave te sindikatave qe pranojne propozimin e ndermjetesuesit te refuzuar nga pala e punedhensve</li> </ul>
Vullnetar/i detyrueshem	Nese nje pale kerkon arbitrim, atehere ai eshte i detyrueshem
Emerimi	Nga lista e vecante e arbitruesve
Perzgjedhja	Me marreveshjen e perbashket te paleve, nese nuk eshte e rastesishme
Procedura	Vendimi behet brenda 10 ditesh pas arbitrimit
<b>Efekti ligjor</b>	Marreveshje kolektive

## 10) Hungari

<b>Metoda</b>	Ndermjetesim
<b>Organizmi</b>	<b>Sherbimi i ndermjetesimit dhe arbitrimit te punes (MKDSZ) (1996)</b>
Vullnetar/i detyrueshem	Me kerkesen e perbashket te paleve
Emerimi	Nga lista e ndermjetesuesve dhe arbitruesve te trajnuar – regjistri zyrtar
Zgjedhja	Kandidatet duhet te permbushin kushte te caktuara: Nenshtetesia, diplome universitare, pese vjet pervoje mbi marredheniet ne pune dhe aftesi komunikuese.
Procedura	Tete vjet per te arritur marreveshjen. Mund te shtyhet edhe pese vjet te tjera – shperblimi qe i paguhet ndermjetesuesit ulet cdo dy vjet – nxitje per zgjidhje te shpejta
Qellimi	Te lehtesoje arritjen e nje marreveshje ne rastet e mosmarreveshjeve kolektive ne pune
Emerimi	5 vjet
Shpenzimet	Ndermjetesimi eshte falas – Arbitrimi paguhet nga punedhenesi
Statistikat	2000: 19 kerkesa – 6 ndermjetesime – 2 arbitrime

## 11) Itali

<b>Metoda</b>	Pajtimi aplikohet ne pjesen me te madhe te marreveshjeve kolektive kombetare. Pajtim dhe ndermjetesim publik per zgjidhen e mosmarreveshjeve te se drejtes dhe te interesit
---------------	--

## 12) Letoni

<b>Metoda</b>	Pajtim – vullnetar
<b>Organizmi</b>	<b>Komisioni i Pajtimit</b>
Anetare	Perfaqesuesit e paleve
Subjekti	Te drejtat kolektive dhe konfliktet e interesit
<b>Efekti ligjor</b>	Detyrues per palet – vlefshmeria e nje marreveshje kolektive
<b>Metoda</b>	Ndermjeteresim – vullnetar
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjeteresuesi</b>
Anetare	Nje person ose nje bord, qe zgjidhet nga palet
Subjekti	Konflikt kolektiv interesti
<b>Efekti ligjor</b>	Me shkrim – vlefshmeria e nje marreveshje kolektive
<b>Metoda</b>	Arbitrim
<b>Organizmi</b>	<b>Gjykata e arbitritimit</b>

## 13) Lituani

<b>Metoda</b>	Pajtim
<b>Organizmi</b>	<b>Komisioni i Pajtimit</b>
Anetare	Numer i njejte perfaqesuesish nga palet - e shumta 5 vete nga secila pale
Procedura	Brenda shtate diteve
<b>Efekti ligjor</b>	Detyrues per palet
<b>Metoda</b>	Ndermjeteresim
	Nje procedure e re e zgjidhjes, u takon paleve te zgjedhin nje ndermjeteresues
<b>Metoda</b>	Arbitrim
<b>Organizmi</b>	<b>Arbitrimi i Punes</b>

## 14) Luksemburg

<b>Metoda</b>	Pajtim (i detyrueshem) dhe Ndermjeteresim +Arbitrim (vullnetar)
<b>Statusi ligjor</b>	Nese pranohet: statusi i marreveshjes kolektive

## 15) Malte

<b>Metoda</b>	Pajtim/ndermjletesim (pa dallim)
<b>Organizmi</b>	<b>Paneli i Pajtimit</b>
Anetare	Jo me pak se pese vete
<b>Qellimi</b>	Te perpiqet te gjeje nje zgjidhje miqesore Te beje rekomandimet e nevojshme per zgjidhje

## 16) Poloni

<b>Metoda</b>	Pajtim
Vullnetar/detyrues	Kur ndermerret nga sindikatat, punedhenesit nuk mund te refuzojne pjesemarrjen
<b>Efekti ligjor</b>	Detyrues per te dyja palet. Nese nuk ka marreveshje: detyrim per t'iu drejtuar ndermjetesimit
<b>Metoda</b>	Ndermjletesim – detyrues
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjetesuesi</b> – i besueshem + i paanshem
Emerimi	Zgjidhet nga lista e Ministrise se Punës dhe Politikave Sociale qe hartohet nga Ministria ne marreveshje me konfederatat me perfaquesues te partnereve sociale
Zgjedhja	Me marreveshje. Nese nuk arrihet, Ministria zgjedh nga lista
Procedura	Jo me shume se 15 dite
Zbatimi	Asgne
<b>Metoda</b>	Arbitrim – vullnetar
<b>Organizmi</b>	<b>Bordi i Arbitrimit</b>
Anetare	Kryetari (gjykates profesionist) + 6 anetare (3 nga secila pale e perfaquesuar)
<b>Efekti ligjor</b>	Detyrues per te dyja palet

## 17) Portugali

<b>Metoda</b>	Ndermjletesim + Pajtim
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjetesuesi</b>
Zgjedhja	Palet zgjedhin ndermjetesuesin
<b>Organizmi</b>	Pajtimi ndermerret ose nga njera pale ose nga te dyja, ose nga Ministria e Punës

## 18) Sllovakia

<b>Metoda</b>	Ndermjetesim + arbitrim
Vullnetar/i detyrueshem	Vullnetar
<b>Organizmi</b>	<b>Ndermjetesim</b>
Emerimi	Nje qytetar i rritur nese figuron ne nje liste zyrtare
Zgjedhja	Bashkarisht nga palet, vetem 60 dite nga propozimi per lidhjen e nje marreveshje te re kolektive. Nese nuk perzgjidhet nga lista e Ministrise se Punës, Çeshtjeve Sociale dhe Familjes
<b>Vendimi</b>	Propozim me shkrim brenda 15 ditesh - qe konsiderohet e deshtuar nese nuk gjendet zgjidhje brenda 30 diteve
<b>Efekti ligjor</b>	
Zbatimi	
<b>Shpenzimet</b>	Ndahen midis paleve
<b>Organizmi</b>	<b>Arbitrim</b> (nese ndermjetesimi ka deshtuar)
Emerimi	Çdo qytetar i rritur nese figuron ne nje liste zyrtare
Zgjedhja	Vetem Ministria nga lista me kerkesen e nje pale, jo i njejt person si ndermjetesuesi
<b>Vendimi</b>	Brenda 15 diteve
<b>Shpenzimet</b>	Nga Ministria
<b>Efekti ligjor</b>	Apelim ne gjykaten civile brenda 15 diteve

## 19) Slovenia

<b>Metoda</b>	Pajtim + Arbitrim I irregulluar vetem per marreveshjet kolektive
---------------	---

## 20) Spanje

<b>Metoda</b>	Pajtim + Ndermjetesim
Vullnetar/i detyrueshem	Pjesa detyruese e marreveshjes kolektive
<b>Organizmi</b>	Komiteti i Perbashket i Marreveshjes Kolektive i ngritur nga partneret sociale
Emerimi	
Zgjedhja	
<b>Efekti ligjor</b>	Statusi i marreveshjes kolektive
Zbatimi	

## 21) Suedi

<b>Metoda</b>	Pajtim (ligji nuk ben dallim midis pajtimit dhe ndermjetesimit)
Vullnetar/ detyrues	Palet jane te detyruara te marrin pjese ne mbledhjet e pajtimit
<b>Organizmi</b>	<b>Instituti Shteteror i Pajtimit</b>
Emerimi	Pajtuesi emerohet nga Instituti
Zgjedhja	Me kerkesen e njerës prej paleve

## **22) Mbreteri e Bashkuar**

<b>Metoda</b>	Pajtim + Arbitrim
<b>Organizmi</b>	<b>ACAS</b>
Zgjedhja	Me kerkesen e njeres prej paleve

## **Pjesa II**

**Sistemet e gjykatave te punes ne Bashkimin European  
dhe ne Europen Juglindore**

**Veshtrim krahasues**

Wiebke Düvel



## Hyrje

Sikurse ilustrohet ne Pjesen I, zgjidhja e mosmarreveshjeve ne pune mund te arrihet ne rruge jashte-gjyqesore. Por kjo nuk do te thote qe ZAM mund te zevendesojne menyrat tradicionale te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne gjykate. Psh. ZAM nuk lejojne rishikimin e nje marreveshjeje te arritur. Gjithashtu, nese njera nga palet nuk i permabahet marreveshjes, zbatimi i saj shpesh behet problematik. Per kete arsyte te dyja menyrat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune- ato jashtgjyqesore dhe gjyqesore- gjithmone duhen konsideruar si plotesuese, ku cdonjera prej tyre i pasuron sistemet kombetare te marredhenieve ne pune me avantazhet e veta.

Per kete qellim, Pjesa II do te hedhe nje veshtirim mbi rrugen gjyqesore te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune. Kjo pjese do te jete nje perqasje krahasimore e sistemeve te gjykatave te punes ne Bashkimin European dhe ne Europen Juglindore. Metoda krahasuese eshte zgjedhur per te treguar shumellojshmerine e sistemeve egzistuese. Kjo shpjegon edhe faktin qe cdo sistem kombetar i marredhenieve ne pune ka gjetur nje menyre korresponduese per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Analiza e sistemeve te gjykatave te punes te 16 Shteteve Anetare te BE behet duke u perqendruar ne parimet krahasimore baze, sic jane struktura, procedura etj.

Informacioni eshte marre nga zhvillimet e fundit ne gjykatat e punes ne Europen JugLindore: Bullgari, Rumani dhe ne vendet e ish Jugosllavise. Do te doja te falenderoja koleget e sindikatave Velitchka Mikova (KNSB – Bullgari), Lucian Vasilesku (CNSLR – Fratia-Rumani), Vesna Cejovic (SSSCG – Mal i Zi) dhe Suncica Benovic (UATUC- Kroaci) per informacionin e vyer qe me kane dhene mbi situaten ne vendin e tyre.

Per disa sisteme kombetare te vecanta, trajtesat jane me te detajuara (France, Gjermani, Hungari dhe Zvicer). Qellimi eshte te pershkruajme me hollesisht disa sisteme te caktuara kombetare. Gjithesesi, perzgjedhja e ketyre vendeve ne asnje menyre nuk ka per qellim te sugjeroje se ato perfaqesojne nje shembull me te mire per rajonin sesa sisteme te tjera kombetare.

Ne fund te pjeses II jane perfshire pasqyra (tabela) te 16 vendeve te BE-se: synimi eshte qe lexuesit te mund te perftojne nje veshtirim te shpejte krahasues te ndryshimeve dhe ngashmerive ne vende te ndryshme. Per informacion te metejshem dhe me te detauar mund t'u referoheni burimeve te cituara ne bibliografi.

## Gjykatat e punes ne Bashkimin European – veshtrim kahasues

Kur flasim per gjykatat e punes, nenkuptojme gjykatat e specializuara ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune, ne dallim nga gjykatat e per gjithshme civile. Keto gjykata perbejne nje menyre per te mbyllur hendekun qe egziston midis te drejtave te punetoreve te garantuara nga legjislacioni dhe zbatimit te tyre ne praktike. Gjykatat e punes ndihmojne qe t'i bejne keto te drejta efikase, sepse, me perjashtim te sindikatave, gjykatat e punes jane forumi i vetem ku mund te drejtohet pjesa me e madhe e punetoreve me qellim qe te realizoje te drejtat e veta.

Trajtesa e me poshtme analizon sistemet e ndryshme te gjykatave te punes ne mbare Bashkimin European, duke analizuar tipare te caktuara qe jane te kahasueshme: si struktura, perberja dhe procedurat. Gjithesesi, gjate kahasimit duhet te kemi parasysh se gjykatat e punes jane te organizuara dhe funksionojne ne menyre te ndryshme ne gjithesecilin vend te Europe, pa harruar faktin se sistemi i gjykatave te punes duhet t'i pershtatet sistemit te marredhenieve ne pune te cdo vendi.

Duke nisur kahasimin me sistemin gjyqesor, mund te thuhet se gjykatat e punes jane ose te perfshira ne sistemin e gjykates civile (si ne Austri, Belgjike, Itali, Portugali dhe Spanje) ose te vecuara nga ajo (si ne Danimarke, Finlande, France, Gjermani dhe Mbreterine e Bashkuar). Me nje fjalë, gjykatat e punes mund te jene pjesa e juridiksonit civil, ose dhoma (chambers) te specializuara; ndryshe, gjykatat e punes mund te formojne nje juridikcion te posacem qe funksionon sipas ligjeve te vecanta. Ne Hollande, nje nga vendet qe merret ne analize, gjykatat e punes nuk egzistojne.

Po te hedhim nje veshtrim ne **perberjen** e gjykatave, shohim se pjesa me e madhe e vendeve kane gjykates amatore ne gjykatat e punes. Termi gjykates amatore perdoret per te dalluar keta gjykates nga gjykatesit profesioniste qe kane formim gjyqesor. Gjykatesit amatore jane per gjithesisht individe qe vijne nga vendet e punes (qe perfaqesojne sindikatat dhe organizatat e punedhenesve) dhe per rrjedhoje kane nje njohje te vecante te jetes se perditshme dhe te problemeve qe lindin ne praktike. Gjykatesit amatore perfshihen ne gjykatat e punes me qellim qe ne gjykimin e ceshtjeve te punes, ata te sjellin njohjen dhe pervojen e tyre mbi tregun e punes, mbi shqetesimet ne vendin e punes si edhe njohjen e vecante te problemeve sociale. Per kete arsy, ne nje sistem me gjykates amatore, palet kane me shume besim tek juridiksoni dhe vendimet e dhena gjithmone e me shpesh konsiderohen te drejta.

Ne shume vende gjykatesit amatore perfaqesojne sindikatat dhe organizatat e punedhenesve, por kjo nuk eshte e domozdoshme, si psh. ne rastin e Hungarie ku 90% e gjykatesve amatore jane pensioniste ose ne rastin e Mbreterise se Bashkuar ku gjykatesit amatore tashme emerohen me konkurs te hapur. Nje shembull interesant perben edhe Luksemburgu ku gjykatesit amatore zgjidhen, sipas rastit, ose nga administrata (punetoret me kollare te bardhe) ose nga punetoret/sindikata (punetoret me kollare blu).

Se pari, nje sistem tri-palesh me gjykates profesioniste dhe gjykates amatore nga sindikatat dhe organizatat e punetoreve mund te haset ne Austri, Belgjike, Danimarke, Finlande, Gjermani, Luksemburg, Sloveni dhe Suedi. Ndersa ne Greqi, Itali, Hollande, Portugali dhe ne Spanje gjykatesit profesioniste vetem emerohen. Franca eshte i vetmi vend ku ceshtjet gjykohen vetem nga perfaqesues te te dyja paleve te marredhenieve ne pune. Gjithashtu, Franca eshte i vetmi vend ku punetoret dhe punedhenesit kane te drejte te zgjedhin gjykatesit amatore. Ne vende te tjera ata emerohen drejtperdrejt nga nje organizem administrativ ose

caktohen nga sindikatat dhe organizatat e punetoreve. Ne Slloveni, gjykatesit amatore emerohen nga asambleja kombetare.

Numri i gjykatesve (amatore dhe profesioniste) ndryshon nga vendi ne vend. Ne pjesen me te madhe te vendeve ka tre gjykates (ose pese apo shtate) ku njeri eshte gjykates profesionist dhe dy jane gjykates amatore. Vetem ne Finlande dhe ne France mund te hasim kater gjykates amatore. E vecanta e sistemit Slloven eshte se numri i gjykatesve ndryshon nga tre per mosmarreveshjet individuale, deri ne pese per mosmarreveshjet kolektive.

**Trajnimi** i gjykatesve amatore eshte nje ceshtje tjeter mbi te cilin duhet te ndalemi, per faktin se detyra e tyre eshte te administrojne drejesine ne mungese te nje formimi ligjor. Gjithesesi kjo konsiderohet si nje pike vertet e dobet, pasi e vettja gje qe keta mund te sjellin ne gjykate jane vec njojurite e tyre praktike dhe jo njojja e elementeve ligjore dhe proceduriale. Ata trajnohen nga organizatat qe i emerojne, si ne Austri, France dhe Gjermani. Ne Belgjike, Danimarke dhe Suedi gjykatesit amatore nuk marrin asnje lloj trajnimi.

Ne kete kontekst, problemi i **paanshmerise se gjykatesve amatore** le per te deshiruar. Gjithesesi, pothuaj te gjitha vendet raportonin se pervoja tregonte qe, si rregull, gjykatesit votoheshin njezeri. Kjo mund te merret si prove e paanshmerise se tyre, qe deshmon se ata nuk votojne thjesht per palen e vet.

Persa i takon marredhenieve midis gjykatesve profesioniste dhe gjykatesve amatore, eshte interesante te shihet se pjesa me e madhe e gjykatesve profesioniste i konsiderojne gjykatesit amatore si nje pasuri/vlere (asset) ne sistemin e tyre.

**Kompetenca** e gjykatave te punes eshte e ndryshme ne te gjitha shtetet anetare te BE-se. Natyra e kategorive te mosmarreveshjeve qe percillen per gjykim ne juridiksione te specializuara eshte e ndryshme. Mosmarreveshjet individuale ne pune trajtohen nga gjykatat e punes vetem ne Belgjike, France, Itali, Luksemburg dhe ne Mbreterine e Bashkuar. E kunderta ndodh ne Danimarke dhe Finlande, ku vetem mosmarreveshjet kolektive ne pune i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave te punes.

Ne Austri, Gjermani, Greqi, Portugali, Slloveni, Spanje dhe Suedi, gjykatat e punes i trajtojne te dyja llojet e mosmarreveshjeve. Gjykatat e punes ne Belgjike, Itali, Slloveni dhe Spanje gjykojne gjithashtu mosmarreveshjet qe kane te bejne me probleme te sigurimit shoqeror.

Edhe **rregullat proceduriale** luajne rol vendimtar ne funksionimin e gjykatave te punes. Epersia e gjykatave te punes eshte se procedurat jane te shpejta, te thjeshta, efikase dhe me pak te kushtueshme sesa procedurat normale gjyqesore.

Procedura te thjeshta jane ato, qe i japin mundesi dikujt qe nuk ka njojuri ligjore, t'i drejtohet gjykates pa nevojen e nje asistence profesionale (jurist). Si fillim, pyetja qe shtrohet eshte: si duhet depozituar nje ankesa.

Ne Mbreterine e Bashkuar, si fillim mbushet nje formular i thjeshte para se te nise procedura gjyqesore, e cila behet e mundur nga nje sere burimesh, psh. nepermjet gjykatave apo nepermjet internetit. Ne Gjermani, per te depozituar nje ankesa, individi mund t'i drejtohet nepunesit te gjykates nese druhet ta beje vete kete gje nga frika se mos gabon apo kur nuk di te lexoje ose te shkruaje.

Sistemi procedural eshte me shume kundershtues se sa investigues per shkak te deshires, qe gjate procedurave, palet ne mosmarreveshje ta marrin vete ne dore situaten.

Rregullat proceduriale ne gjykatat e punes jane shpesh me informale sesa ne gjykatat civile, per shkak te idese se lartpermendur qe punetoreve nuk u duhet te pajtojne avokat, te detyruar nga faktore te jashtem, nese ata nuk bejne pjese ne sindikata dhe per rrjedhoje nuk perfaqesohen prej saj. Keto ndryshime behen ose kur rastet e mosmarreveshjeve ne pune perjashtohen nga procedura civile, ose kur vendet kane nje procedure te vecante per gjykatat e punes, sikurse ne Belgjike, France, Portugali dhe Gjermani.

Por ndonese rregullat jane me informale, ne vendet qe po marrim ne analize vihet re nje tendence drejt rritjes se rolit te avokateve.

Nje subjekt tjeter i rendesishem mbi te cilin duhet ndalur, eshte ai i **mundesise per t'ju drejtuar (aksesibilitetit)** gjykatave. Shperndarja gjeografike e gjykatave eshte pa dyshim e lidhur me transportin publik dhe me faktin qe drejtesia duhet te behet me e arritshme (e prekshme) per te gjithe.

Ne mjediset e gjykatave te per gjithshme duhet te kete salla te nevojshme per mbledhje, me shperndarje gjeografike ne gjithe territorin e vendit. Filanda paraqet nje shembull te kundertka vetem nje gjykate pune per te gjithe vendin, pa harruar faktin qe kjo gjykate pune shqyrton vetem mosmarreveshjet kolektive. Keshtu, punetori i izoluar dhe i pa sindikuar nuk ka asnje motiv te marre rrugen per t'u paraqitur ne seancen gjyquesore.

Psh. ne Mbreterine e Bashkuar dikur egzistonin vetem fare pak mjedise stabel dhe gjykatesve u duhej te udhetonin lart e poshte sa here qe kishin ceshtje per te zgjidhur. Ne Gjermani ditet e gjyqit zhvillohen nje here ne jave ne zonat ku normalisht nuk ka gjykate pune, me qellim qe te plotesohen nevojat e zonave me rurale.

**Mirekuptimi paraprak paqesor** i ceshtjes, ne menyra te ndryshme, eshte nje aspekt kryesor i zgjidhjes se mosmarreveshjeve. Ky eshte nje faktor shume i rendesishem, jo thjesht nga pikepamja e kohes dhe e shpenzimeve.

Nese palet arrijne mirekuptim, kjo shmang nje procedure te gjate gjyquesore, ndoshta disa seanca dhe natyrish shkurton ndjeshem procedurat. Gjithashtu ne disa vende parashikohen stimuj ose shperblime per rastet kur mosmarreveshjet zgjidhen ne menyre paqesore, psh.shperblime ne formen e tarifave me te ulta gjyquesore.

Ne shumicen e vendeve, zgjidhjet paqesore te mosmarreveshjeve karakterizohen nga disa vecori : ose nje kerkese mandatore (detyruese) per te nisur procedurat gjyquesore me zgjidhje paqesore (Danimarke, Finlande, Irlande, Itali, Spanje dhe Suedi), qe perdoren brenda procedurave gjyquesore perpara gjykimit te ceshtjes, si nje instance e pare pajtimi (Belgjike,Danimarke, France, Gjermani, Sloveni, Spanje dhe Suedi) ose si nje metode qe perdoret gjate gjithe procedures ( ne Danimarke, Itali, Gjermani, Suedi dhe ne Mbreterine e Bashkuar). Hollanda eshte thjesht ne fazen e eksperimentimit te zgjidhjeve paqesore ne gjykate.

Ne te vertete, zgjidhjet paqesore ne mosmarreveshjet e ligjit te punes, jane me te parapelqyera sesa vendimet e gjykates, per te menjanuar keshtu konceptin e "fituesit" dhe te "humbesit", perderisa palet ne mosmarreveshje shpesh i ruajne marredheniet dhe u duhet te punojne bashkarisht edhe pas mbarimit te konfliktit.

**Perfaqesimi** eshte nje faktor me rendesi per paraqitjen ne gjykate. Shume punetore ndihen mire kur shkojne ne gjykate pa qene te perfaqesuar, madje edhe kur kjo behet e mundur nga nje sere rregullash proceduriale ne Shtetet Anetare te BE-se. Megjithate, punetoret shpesher i druhën detyrimeve (shpenzimeve) financiare per te punesuar nje avokat qe t'i perfaqesoje ne gjyq. Per kete arsy, perfaqesimi i punetoreve eshte nje sherbim i rendesishem qe kryhet nga sindikatat per anetaret e vet. Ne pjesen me te madhe te vendeve, sindikatat lejohen te perfaqesojne dhe te ndihmojne anetaret e vet ne gjykatat e punes. Vetem ne Finlande sindikatat nuk lejohen te perfaqesojne anetaret e tyre, ndersa ne Portugali perfaqesimi eshte i mundur vecse ne raste te vecanta. Natyrisht, ne cdo vend sindikatat jane te lira te percaktojne kushtet per mbrojtjen e punetoreve, psh.kushtin e anetaresise.

**Kohezgjatja** ka shume rendesi per nje ceshtje gjyqesore. Punetoret e pushuar qe shpresojne te rikthehen ne vendin e punes ose ata qe kerkojne pagate prapambetura, nuk mund te presin me vite vendimin qe do te shpallo te drejtat e tyre, te cilin ata me pas do ta zbatojne. Madje, edhe kur marredheniet vazhdojne, eshte e rendesishme te merret nje vendim i shpejte; ne rastet e mosmarreveshjeve ne pune kjo mund te ndihmoje per te shmangur ose per te shkurtuar kohezgjatjen e greves.

Ne kete rast, perdonimi i disa instanca mund te paraqese veshtiresi, por kjo behet e mundur nga percaktimi i afateve konkrete kohore per depozitimin e nje ankesse si dhe nga periudha kohore qe gjykatesi dhe palet duhet te respektojne. Gjithashtu ne shumicen e vendeve ka dispozita per nje "procedure urgjente" per rastet kur palet rrezikojne te humbasin te drejtat e tyre ne prije te perfundimit te procedures normale gjyqesore (Finlande, France, Gjermani, Itali, Luksemburg dhe Hollande).

Ia vlen te behet krahasimi i volumit te rasteve ne vende te ndryshme dhe i periudhave mesatare kohore qe nevojitet per t'i zgjidhur ato:

Vendi	Instanca e pare	Apeli	Periudha kohore mesatare
Danimarke	724	-----	86 dite-mosparaqitje 194 dite- vendim 1 vit –proces gjykimi
Finlande	135	11	4-5 muaj
France	160,000	55,000	75% > 1 vit
Gjermani	600,000	22,000	2% > 1 vit (shperndarje seance) 4% > 1 vit (te tjera)
Itali	<b>1,012367</b>	126,772	<b>&gt;1 vit</b>
Sloveni	7,042	2,708	<b>69,2%&gt;1 vit (2001)</b>
Suedi	400	40%	10% > 1 Vit
Mbreteri e Bashkuar	98,617	1-938	17% > 1 vit

Te dhena nga 2002- Burimet: <http://www.oikeus.fi/tyotuomioistuin/2026.htm>; <http://www.ilo.org/public/english/dialogue/ifdial/ii/lc.htm>

Sic mund te shihet, volumi i rasteve ndryshon ndjeshem ne vende te ndryshme.

Ka disa aspekte qe mund te shpjegojne keto shifra: qe vendet Nordike jane vendet me numrin me te vogel te rasteve shpjegohet nga fakti se vetem mosmarreveshjet kolektive ne punë percillen ne gjykate, por ky shpjegim vlen vetem per Danimarken dhe Finlanden. Po ne Suedi c'ndodh?

Volumi i rasteve gjithashtu mund te percaktohet nga numri i te punesuarve ne vendet ne fjale. Por Gjermania kishte nje fuqi punetore prej rreth 36,500,000 per 600,000 raste ne vitin 2002, ndersa Italia kishte nje fuqi punetore prej 21 milion dhe mbi 1 milion raste ne te njejtin vit. Per rrjedhoje, ky fakt nuk mund te shpjegohet me numrin e individave ne nje marredhenie punë.

As vartesia midis zgjidhjes paraprake paqesore, perpara zhvillimit te procedurave gjyquesore, dhe numrit te ceshtjeve nuk mund te sherbeje per te shpjeguar rastin, sepse kjo eshte e detyrueshme ne Itali, dhe megjithate Italia mbetet ende vendi me numrin me te madh te rasteve. Ceshtja eshte shume me e komplikuar dhe duhen marre ne konsiderate shume aspekte te sistemit ligjor, si tarifat per avokatet ne gjykate, dobishmeria e zgjidhjes paraprake paqesore dhe ndoshta gatishmeria e njerezve per t'ju drejtuar ligjit per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ne te kundert, volumi i rasteve dhe koha mesatare per zgjidhjen e mosmarreveshjeve persa i perket Gjermanise mund te percaktohet ne shkallen me te ulet, ndersa per Sllovenine ne shkallen me te larte.

Shpenzimet (kostot), perfshi tarifat e gjykates, tarifat e avokatit, tarifat e ekspertit etj, shpesha perbejne nje pengese e madhe per njerezit qe duan te mbrojne te drejtat e tyre. Kjo eshte edhe arsyja qe shume vende kane gjetur menyra per ta bere nje institucion kaq te rendesishem sa c'jane gjykatat e punes, me kosto me te ulet per publikun e gjere.

Menyrat qe ndeshen me shpesha jane: tarifa me te ulta gjyquesore (Danimarke, Finlande, Gjermani, Greqi, Slloveni dhe Portugali), asnje tarife gjyquesore (Mbreteri e Bashkuar, Spanje, France dhe Hungari - per punetoret), asnje tarife kur marreveshja arrihet jashte dyerive te gjyqit (Gjermani), pala humbese nuk detyrohet te paguaje tarifa per te mbuluar shpenzimet e avokateve te pales fituese (Danimarke, Gjermani), asistence ligjore falas, perfaqesimi i sindikates dhe ndihma financiare per personat me te ardhura te pakta (Finlande, Gjermani dhe Hungari).

Mundesa per **apelim** egziston ne te gjitha vendet me perjashtim te vendeve Nordike (Danimarke, Finlande dhe Suedi). Gjykatesit amatore i gjejme ne te gjitha instancat ne Austri dhe Gjermani; ne shkallen e pare dhe te dyte, ata i gjejme ne Belgjike. Ndersa ne shkallen e pare, gjykates amatore ka vetem ne France, Hungari, Slloveni dhe ne Mbreterine e Bashkuar.

Pas perfundimit te procedures gjyquesore, shtrohet problemi i **zbatimit** te vendimit. Ketu dallojme kater raste, qe perkatesisht jane: zbatimi i menjehershem i vendimit si ne Finlande, France, Itali dhe Luksemburg (per vendimet qe kane te bejne me pagen); zbatimi pas nje afati kohe prej dy javesh si ne Danimarke; vendimet jane te zbatueshme perkothesisht (ne Austri dhe Belgjike nga gjykatesi, ne Gjermani automatikisht nga ligji); ose zbatimi shtyhet pas vendimit te apelit (ne Belgjike dhe ne Mbreterine e Bashkuar).

Gjate perqatitjes per ngritjen e gjykatave te punes, ka shume rendesi te shtrohet pyetja se cfare do te ndodhe nese **gjykatat e punes frekuentohen gjeresisht**, gje qe eshte krejt e mundur per

shkak te numrit te larte te pezullimeve nga puna, te rrogave te papaguara dhe te mosmarreveshjeve kolektive. Kjo pyetje ka shume rendesi edhe per vendet ku nderkohe nje numer i madh njerezish i drejtohen gjykatave te punes.

Sigurisht, ka mjaft rendesi qe gjykatat e punes te kene staf te mjaftueshem per t'i bere balle te gjitha rasteve qe drejtohen tek to, pasi ne te kundert avantazhi i nje procedure te pershpejtur do te humbase. Procedura duhet te jete efikase dhe koha e gjykatesit duhet shfrytezuar ne maksimum (psh. vendimet gojore dhe perdonimi i internetit). Gjykatesit duhet te jene te kualifikuar dhe te afte, gje qe arrihet nepermjet trajnimit. Procedurat para-gjyquesore per zgjidhjen e ceshtjeve ne fazen fillestare ndihmojne per te zbutur problemin, nese seancat gjyquesore konceptohen si nje perpjekje e fundit per pajtimin e paleve.

**Roli i gjykatave te punes** eshte i lidhur ngushte me sistemin e marredhenieve ne pune te nje vendi, gjithesesи hasim kater vecori te per gjithshme. Eshte e kuptueshme se roli i tyre eshte te zgjidhin nje rast te vecante te paraqitur ne gjykate, te nxisin palet t'u kthehen bisedimeve dhe t'i ndihmojne ato te gjejne mirekuptim. Gjithashtu, gjykatat kane funksionin e hartimit te politikave per vendosjen e nje ekuilibri te arsyeshem forcash si edhe funksionin e hartimit te ligjeve.

Funksioni i hartimit te politikave nenkupton faktin qe gjykatat e punes duhet te zbatojne nje politike sociale dhe, ne kete rast, ato i zhvillojne keto politika duke bere interpretimin e tyre. Gjykatat e punes jane pa dyshim nje mjet i rendesishem per zbatimin e normave themelore te punes dhe si te tilla jane pjesa e sistemit te hartimit te politikave sociale, i cili perbehet nga organizma qeveritare qe veprojne per kete qellim. Per rrjedhoje, ka shume rendesi qe gjykatesit te jalin vendime te qarta dhe transparente lidhur me politikat sociale.

Duke perpunuar dhe aktualizuar te drejtat e punetoreve, gjykatat e punes ndikojne mbi ligjin e punes. Lidhja midis ligjshmerise dhe legjislacionit behet me e qarte kur mbas dhenies se vendimeve te caktuara gjyquesore, legjislacioni ndryshon. Kjo vlen edhe per rastet kur nje gjyka pune duhet te zgjidhe nje ceshtje te paraqitur ne gjykate dhe nuk ka dispozita ligjore per ta bere kete. Ne kete rast, gjykata nuk mund t'i lere palet pa per gjigje dhe duhet te krijoje vete nje dispozite per te interpretuar ligjin duke mos harruar per asnje cast parimet e percaktuara nga legjislacioni, ligji dhe doktrina. Keto situata hasen shpesh per shkak te ndryshimeve te shpejta qe ndodhin ne tregun e punes. Kjo con ne nderveprimin midis gjykatave te punes dhe legjislacionit me ligjevenesin. Ne shume vende, gjykatat kane perpunuar rregullore mbi te drejten per greve dhe mbylljen e ndermarrjeve si edhe mbi te drejten e punetoreve per t'u anetaresuar ose jo ne sindikate.

Per vendet qe porsa jane pranuar ne BE si edhe per ato qe do te pranohen ne te ardhmen, **lidhja midis gjykatave kombetare dhe ligjit te BE-se** eshte me shume interes. Vecanerisht me interes eshte mundesa per te perdonur ligjin e BE-se ne gjykatat kombetare, si edhe mundesa per te paraqitur nje ceshje ne Gjykatene Europeane te Drejtisise (ECJ).

Procedura paraprake qe mbizoteron ne ECJ, ne rastet kur nje gjyka kombetare i kerkon shpjegime ECJ-se, mund te jete me interes per sindikatat. Perfaqesimi i paleve ne ECJ-se eshte i njejtë si ne procesin fillestar ne nivel kombetar, qe do te thote se sindikatat qe perfaqesojne nje pale ne ceshtjen gjyquesore fillestare ne gjykaten kombetare mund t'i bejne nje kerkese me shkrim ECJ-se. Kjo u jep mundesi sindikatave t'i drejtohen direkt ECJ-se per te deklaruar mendimin e tyre mbi ceshjen dhe mbi problemet kryesore qe fshihen pas procedurave aktuale.

Per me teper, ligji i ECJ-se ne fushen sociale mund te sherbeje si pike referimi per hartimin e nje juridiksion i ri qe nuk ka traditen e gjykatave te specializuara te punes.

**Shkurtimisht**, gjykatat e punes qe u perqigjen sistemeve specifike kombetare te marredhenieve ne pune kane shume avantazhe, me e rendesishmja e te cilave eshte t'u jape punetoreve nje arme per te fituar te drejtat e tyre te parashikuara nga legjislacioni. Avantazhet e tjera mund te permblidhen si me poshte: gjykatat e punes ofrojne procedura me te shpejta; gjykatesit ofrojne njohuri te vecanta ne fushat sociale qe gjykatesit e ceshtjeve civile nuk i kane dhe nuk mund t'i kene; gjykatesit amatore sjellin ne gjykate njohjen e tyre mbi tregun e punes dhe bejne qe numri i njerezve qe i pranojne vendimet, te iritet; procedurat e depozitimit te ankesave dhe ato gjyqesore behen me te thjeshta; sindikatat kane mundesi te perfaqesojne anetaret e vet dhe, ne perqjithesi, procedura eshte me pak e kushtueshme.

**Shembuj nga vende te ndryshme**

**Gjermani**

**Hungari**

**Zvicer**

**Europa Juglindore**



## **Rregullimi i mosmarreveshjeve ne pune ne Gjermani**

Kjo trajtese hedh veshtrimin mbi tre nivelet e rregullimit te mosmarreveshjeve ne pune ne sistemin gjerman. Rregullimi i mosmarreveshjeve ne pune behet kryesisht nga gjykatat e punes, per arsyse se juridikzioni trajton si mosmarreveshjet individuale ashtu edhe ato kolektive. Se dyti, partneret sociale kane pavaresine te paraqesin zgjidhje te mosmarreveshjeve kolektive para bordit te pajtimit, per sa kohe qe marreveshja kolektive permboj dispoziten e kerkuar. Se fundi, por jo me pak e rendesishme, ligji per mosmarreveshjet ne keshillat e punes, parashikon nje procedure te vecante per zgjidhjen e mosmarreveshjeve, qe ne Gjermani njihet me termin “Einigungsstelle”.

### **Rregullimi i mosmarreveshjeve brenda dispozitave te miratuara bashkarisht**

Ne marreveshjet kolektive partneret sociale mund te percaktojne vete proceduren per rregullimin e mosmarreveshjeve, qellimi kryesor i se ciles eshte te nxise mirekuptimin dhe te parandaloje grevat dhe mbylljen e ndermarrjeve. Pas percaktimit te detajeve te procedures brenda vete marreveshes kolektive, marreveshja ndryshon nga nje marredhenie pune ne tjetren, dhe per kete arsyse kjo trajtese nuk mund te shpjegoje tjeter pervecse karakteristikat e saj kryesore. Zgjidhja e mosmarreveshjes mund te kerkohet te behet e menjehershme (ad-hoc) ne vartesi te mosmarreveshjes, te perfundimit te marreveshjes kolektive dhe te bisedimeve per nje marreveshje te re, ose ne vartesi te te gjitha marreveshjeve kolektive.

Ne sistemin gjerman te kontrates kolektive, nje nga kriteret baze eshte detyrimi per paqe. Cdo veprim i punedhenesit mbi nje ceshtje te rregulluar nga marreveshja kolektive, eshte i ndaluar deri ne mbarimin e afatit te marreveshjes kolektive. Ne disa marreveshje, detyrimi per paqe shtrihet madje deri ne zgjidhjen e mosmarreveshjes.

Bordet e pajtimit zakonisht perbehen nga pajtues te te dyja paleve te partnereve sociale dhe nga nje kryetar, i cili zgjidhet nga ata vete ose nga nje pale e trete. Partneret sociale duhet te bien dakord per kryetarin; ne te kundert, ai/ajo duhet te emerohet me short ose nga pala e trete.

Marreveshja kolektive nuk permboj rregulla proceduriale te detajuara. Zgjidhja e mosmarreveshjeve mund te ndermerret nga njera pale ose nga te dyja. Asnje prej mbledhjeve te bordit nuk behet publike. Gjate mbledhjes, behet degjimi i paleve dhe vleresimi i dokumenteve te paraqitur. Bordi duhet te inkurajoje palet te arrijne mirekuptim dhe jo te bejne propozim. Palet duhet te kene te drejte te ftojne eksperte ne rast se ata mendojne se kjo eshte e nevojshme. Shpenzimet e procedures ndahen midis paleve.

Nese te dyja palet bien dakord, perpara ose pas perfundimit te marreveshjes, kur ajo ka karakter ligjor detyrues, marreveshja qe arrihet nepermjet procedures se rregullimit te mosmarrevshjeve, ka efektin ligjor te nje marreveshjeje te re kolektive.

### **Rregullimi i mosmarreveshjeve qe lidhen me ceshtje te keshillave te punes – “Einigungsstelle”**

“Einigungsstelle” ofron mundesi per rregullimin e mosmarreveshjeve brenda ndermarrjes per mosmarreveshjet qe lindin midis punedhenesit dhe keshillit te punes. Kjo eshte nje menyre

per te zgjidhur mosmarreveshjen ne nivel ndermarrje, ne rastet kur keshillat e punes nuk kane te drejte per greve per shkak te detyrimit per paqe, parashikuar nga ligji. Procedura perpara “Einigungsstelle-s” synon te kompensoje kete mungese te veprimit kolektiv.

Kur “Einigungsstelle” zbatohet menjehere (ad-hoc), me qellim qe te zgjidhe nje problem konkret midis paleve, paraprakisht lindin tre pyetje qe kerkojne perqjigje: Cila eshte ceshtja qe kerkon zgjidhje? Sa vete marrin pjese ne bord nga secila pale? Kush do ta kryesoje bordin?

Kuptohet, qe pyetja e pare ka te beje me kompetencen e “Einigungsstelle”. Ajo trajton mosmarreveshjet ne nivel ndermarrje, psh. bashke vendim-marrjen lidhur me problemet sociale dhe me planet e ristrukturimit.

Pyetja e dyte dhe e trete ka te beje me perberjen e bordit. Ligji shprehet vetem se numri i pjesemarresve nga keshilli i punes dhe pala e punedhenesve duhet te jete i barabarte dhe se duhet te emerohet nje kryetar i pavarur. Per rrjedhoje, palet jane te lira te zgjedhin numrin dhe anetaret qe mund te jene ose brenda ose jashte ndermarrjes. Numri i pjesemarresve varet nga veshiresia e ceshtjes dhe perqjithesisht ka dy-tre te tille. Nese palet nuk bien dakord per numrin, atehere vendimi merret nga gjykata e punes. Problemi kryesor ne praktike mbetet emerimi i kryetarit. Edhe ne kete rast, kur palet nuk bien dakord, perseri vendos e gjykata e punes. Ne shumicen e rasteve, kryetari i emeruar eshte nje gjykates qe trajton ligjet e punes.

Kryetari luan te njejtin roj si ndermjetesi; ai/ajo duhet te njohe situaten/konfliktin dhe duhet te jete i gatshem t'i orientoje palet drejt arritjes se mirekuptimit Ky ligj nuk jep detaje mbi proceduren. Palet mund te bien dakord per nje zgjidhje; ne te kundert, zgjidhja propozohet nga bordi. Vendimi merret me shumice votash, por ne dy faza. Ne raundin e pare, kryetari nuk ka te drejte te votoje; vetem ne rastet kur nuk ka shumice, kryetari mund te votoje ne raundin e dyte. Vendimet duhet te paraqiten me shkrim dhe te firmosen nga kryetari. Ato duhet t'i percillen pa vonese punedhenesit dhe keshillit te punes.

Marreveshja e arritur ka te njejtin status ligjor sikurse dhe marreveshja kolektive ne nivel ndermarrje. Si e tille, ajo eshte ligjerisht e detyrueshme. Punedhenesit i kerkohet te zbatoje vendimin. Nese ai nuk e ben kete, keshilli i punes mund te kerkoje zbatimin e vendimit me ane te procedurave te gjykates se punes.

Punedhenesi paguan shpenzimet e procedures. Ata anetare te bordit qe jane punemarres ne ndermarrje, marrin pagen e tyre te zakonshme; kurse te gjithe ata qe nuk jane te punesar ne ndermarrje sikurse dhe kryetari, paguhen ne baze te marreveshjes kontrakturale.

Vendimi mund te percillet per rishikim ne gjykaten e punes kur interesat e paleve nuk jane respektuar sic duhet. Cdo kerkese per rishikim duhet te behet brenda dy javesh nga njoftimi i vendimit nga kryetari.

## Rregullimi i mosmarreveshjeve ne gjykatat e punes

Ne Gjermani, gjykatat e punes jane nje juridikcion i vecante dhe frekuentohen gjeresisht. Ne vitin 2002, ne gjithe Gjermanine, u depozituan 625,323 ankesa, nga te cilat 91,7% e tyre vinin nga pala e punemarresve. Numri me i madh i ceshtjeve kishte te bente me egzistencen ose mosegzistencen e nje marredhenie pune dhe me pezullimet nga puna (41,5%), ndersa 28,5% kishin te benin me shperblimin. 73,9 % e rasteve u zgjidhen brenda vitit 2002, 45% me marreveshje dhe vetem 6,6% me gjykim.

Ne te njejtin vit, Gjermania kishte 1,154 gjykates profesioniste ne 122 gjykata pune dhe 19 ne gjykatat e apelit.

Persa i perket afatit kohor te rregullimit te mosmarreveshjeve ne vitin 2002, 23% e rasteve te mosmarreveshjeve mbi egzistencen ose mosegzistencen e marredhenieve te punes, u zgjidhen ne me pak se nje muaj, po ashtu edhe 20% e mosmarreveshjeve te tjera. 43% e ceshtjeve u zgjidhen brenda nje periudhe nga 1-3 muaj dhe vetem 1, 9% e ceshtjeve mbi egzistencen ose mosegzistencen e marredhenieve te punes zgjaten me shume se nje vit (4% per mosmarreveshje te tjera).

Gjermania ka nje ligj per proceduren ne gjykatat e punes, i cili parashikon disa rregulla specifike proceduriale. Kur nuk parashikohen specifikime, ligji i referohet nenit te kodit te procedures civile. Por nuk mund te leme pa permendur se ne nivelet politike gjermane po diskutohet problemi i integrimit te gjykatave te punes ne sistemet e per gjithshme te gjykates civile per arsyte ekonomike dhe per te bere kursime financiare. Kjo nuk nenkupton zhdukjen e gjykatave te specializuara te punes, por perfshirjen e tyre ne gjykatat civile. Ky projekt kundershtohet dhe kritikohet me force nga ekspertet e fushes.

Gjykatat e punes ne Gjermani funksionojne ne te treja shkallet me dy gjykates amatore dhe nje gjykates profesionist (nje ne shkallen e pare, ndersa i dyti dhe i treti ne shkallen e trete).

Gjykatesit amatore emerohen nga autoriteti qeveritar pergjegjes, sipas per zgjedhjes se bere nga lista e paraqitur nga sindikatat dhe shoqatat e punedheneve.

Per te ushtruar profesionin e gjykatesit amator, duhen plotesuar vetem dy kushte; te kesh mbushur moshen 25 vjec dhe te jesh aktiv ne distriktin e gjykates se punes.

Ligji gjerman per gjykatat e punes parashikon dy procedura. Ajo qe haset me shpesh eshte procedura qe con ne gjykim “Urteilsverfahren”; e dyta eshte procedura qe con ne vendim “Beschlussverfahren”, e cila perdoret kryesisht per procese gjyqesore mbi bazen e ligeve (akteve) te keshillave te punes “Betriebsverfassungsgesetz”.

Procedura e pare perdoret, midis te tjerash per ceshtje gjyqesore qe mbeshteten mbi marredheniet e punes, per ceshtje gjyqesore midis paleve qe paraprakisht kane lidhur nje marreveshje kolektive; per ceshtje gjyqesore mbi egzistencen ose mosegzistencen e marreveshjeve kolektive dhe per ceshtje qe kane te bejne me veprimin kolektiv dhe me lirine e shoqatave kur eshte fjala per veprime te paligjshme.

Si rregull, gjyqi nis me nje séance pajtimi midis gjykatesit profesionist dhe paleve, me qellim qe palet te arrijne nje zgjidhje paqesore. Nese gjyqi rezulton me sukses, nuk paguhet asnje tarife gjyqesore. Nese nuk arrihet nje zgjidhje, ceshtja dergohet ne séancen degjimore ku marrin pjese te tre gjykatesit. Kjo séance per gatitet ne menyre te tille qe vetem nje séance eshte e mjaftueshme. Vendimi i gjyqit duhet te jepet menjehere pas gjykimit te ceshtjes.

Rastet e pezullimit nga puna kane gjithnjë per paresi ndaj rasteve te tjera dhe procedura e pajtimit duhet te behet brenda dy javesh nga fillimi i procedures.

Sindikatat dhe organizatat e punedheneve mund t'i perfaqesojne anetaret e vet ne gjykatat e punes, por vetem ne shkallen e pare.

Ne kundershtim me proceduren e gjykates civile, ne gjykatat e punes nuk ka rritje te shpenzimeve. Tarifat gjyqesore ne shkallen e pare mund te shkojne nga 10-500 Euro ne vartesi te rendesise (vleres) se mosmarreveshjes. Secila nga palet paguan shpenzimet e veta ne shkallen e pare, te tilla si tarifat e avokatit, shpenzimet e udhetimit etj.

Asistenca ligjore mund t'i jepet njeres pale nga gjykatesi, nese personi dhe kushtet e tij ekonomike nuk jane te mjaftueshme dhe nese ceshtja ka mundesi te fitohet. Nje mundesi tjeter eshte kur njeres pale i caktohet nje avokat me kerkesen e vet nese pala kundershtare e ka avokatin. Kur pala nuk eshte ne gjendje te paguaje shpenzimet, avokati paguhet nga shteti, por tarifat gjyqesore mbeten perseri detyrim i pales.

Vendimet gjyqesore jane te zbatueshme perkohesisht nga ligji edhe ne rastet kur rishikimi i vendimit ne apel eshte ende i mundshem. Perjashtimi nga kjo kerkesa mund te pranohet nese i pandehuri demonstron se zbatimi mund te krijoje nje disavantazh qe s'mund te kompensohet. Zbatimi perfundimtar eshte i mundur krahas zhvillimit te procedures civile.

Apelimi duhet te percillet ne gjykaten e apelit, ndersa rishikimi i vendimit ne gjykaten federale te punes; kjo e fundit gjykon vetem mbi ligjin, ndersa shkalla e pare dhe e dyte gjykojne mbi faktin dhe mbi ligjin.

# Zgjidhja e mosmarreveshjeve ne pune ne Hungari

Judit Ivany Czugler

## Shifra

Sipas nje studimi te botuar ne vitin 2000<sup>1</sup>, ne Hungari mosmarreveshjet mbi ligjin e punes per gjithesisht lindin (rreth 85% e tyre) kur mbaron nje marredhenie pune, pavaresisht nga permbajtja e ceshtjes. Shifra te tjera te rendesishme qe paraqiten ne kete trajtese, tregojne se procedurat e mosmarreveshjeve u ndermoren kryesisht nga punemarresit (97.3%, pra shume me teper punetore se sa drejtues). Procedurat zgjaten me pak se 6 muaj ne 67% te rasteve, 7-12 muaj ne 26.8% te rasteve dhe mbi 18 muaj ne 1% te rasteve.

Studimi tregoi se punetoret perfaqesheshin nga avokatet ne 50% te rasteve, kundrejt 68% ne rastet e menazhereve dhe profesionisteve te tjere ose te punemarresve me arsim me te larte. Avokatet e sindikatave i perfaqesonin punetoret e tyre vetem ne 8% te rasteve.

Ceshtjet mund te kategorizohen si vijon: paga dhe shpenzime te tjera financiare (36%); mbarimi i marredhenies se punes (41%); rastet disiplinore, perfshi pezullimet nga puna (15%); si edhe vendosja dhe permiresimi i kontratave te punesimit (7%).

## *Numri i ceshtjeve (ne mbare vendin)*

Ne vitin 2003 numri i ceshtjeve te reja, qe kishin te benin me ligjin e punes, te paraqitura ne 20 Gjykatat e Punes ne Hungari ishte 29,995; pervec 26,718 ceshtjeve qe perfunduan dhe 17,867 e ceshtjeve qe ishin ne vazhdim e siper. Gjykata me e mbingarkuar ishte Gjykata e Punes ne Budapest me 6,713 ceshtje te reja, 6,272 te perfunduara dhe me 4,443 ceshtje ne vazhdim e siper.

## Histori

Ne vitin 1992, ne Hungari, hyri ne fuqi Kodi i ri i Punes, i cili synonte te pasqyronte nevojat e nje ekonomie te re tregu. Ky Kod, gjithashtu, mishiron nje metode dhe rregulla te reja ne fushen e mosmarreveshjeve ne pune. Ndryshimet me te rendesishme midis ketyre dy kodeve, behen edhe me te qarta po te krahasojme sistemin e ri te mosmarreveshjeve ne pune me ate te meparshem.

## *Sistemi i mosmarreveshjeve ne pune perpara vitit 1992*

Perpara vitit 1992, mosmarreveshjet ne pune rregulloheshin me Kodin e Punes te vitit 1967 (Akti II i 1967-s qe hyri ne fuqi ne fillim te vitit 1968). Per kete aplikohet nje procedure uniforme per te gjithe punemarresit, perfshi edhe punonjesit publike.

Struktura e sistemit gjyqesor ndryshonte nga sistemi i vendosur ne vitin 1992 - midis ketyre dy vendimeve (viteve) ai u zhvillua ne tre faza te ndryshme:

---

<sup>1</sup> Ne nje studim te bazuar mbi nje veshtrim sociologjik botuar ne vitin 2000, qe analizonte 339 raste te Gjykates se Punes, Funksionimin e Gjykates se Punes dhe Studime mbi Ligjin (Budapest: ELTE, 2000).

- a) 1968-72 : Ne kete periudhe, ne nivelin e pare te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne pune, u krijuan te ashtuquajturat komitete te arbitrimit te punes ne nivel ndermarrje kudo ku kishte sindikata (me shume se 90% e ndermarrjeve). Keto Komitete perbeheshin nga tre anetare, te cilet zgjidheshin nga punetoret per pese vjet. Kandidatet caktoheshin nga punedhenesi dhe nga sindikata ne vendin e punes. Komiteti kishte funksionin e nje forumi "quasi"(pothuajse) gjyqesor te shkalles se pare per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune. Vendimi qe merrte ky Komitet - ne mungese te nje apelimi - kishte vlefshmerine e vendimit te gjykates dhe ishte i apelueshem ne gjykaten civile lokale te shkalles se pare, e cila merrte vendimin perfundimtar. Vetem ne rastet e nje demshperblimi te padrejte, mund t'i drejtoheshe Gjykates se Apelit. Ne ato vite, nuk kishte rregulla per trajtimin e mosmarreveshjeve te vecanta te interesit.
- b) 1972-89 : Ne vitin 1972, ne gjykatat e shkalles se pare ne nivel vendor (rajonal) dhe ne Budapest u ngriten Gjykatat speciale te Punes.

Ndonse elementet e tjere te sistemit gjyqesor mbeten ashtu siç ishin, ngritja e gjykatave te specializuara ndikoi mjaft pozitivisht ne evolucionin e ligjit nepermjet interpretimit ligor te rasteve.

- c) 1989-92 : Ne 1989, ne ligjin e punes dhe ne procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve te interesit, u shfaqen elemente te rinj qe sinjalizuan transformimet e pashmangshme politike, ekonomike dhe sociale. Ne nje fare mase, ligji njihte/pranonte egzistencen e mosmarreveshjeve ne pune dhe linte hapesire per nje procedure te posacme per zgjidhjen e tyre. Secila pale kishte te drejte te delegonte nje anetar (perfaquesuesin e vet) ne Komitetet e pajtimit, te perbere nga tre vete, te cilet me pas zgjidhnin sebashku anetarin e trete. Vendimi i komitetit nuk ishte detyrues, neqoftese vete palet nuk e kerkonin ate paraprakisht me shkrim.<sup>2</sup>

Institucioni i ri ishte i domozdoshem per shkak te rritjes se numrit te grevave. Gjithashtu ai sherbente per te nxitur gjetjen e zgjidhjeve paqesore te mosmarreveshjeve kolektive.

### ***Sistemi i mosmarreveshjeve ne pune pas vitit 1992***

Kodi i ri Punes u miratua ne 1 Korrik 1992, duke vendosur ne kete menyre nje sistem te ri per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune.

#### ***Karakteristikat kryesore te sistemit te ri***

- **Komitetet e arbitrimit** ne nivel ndermarrje u shfuqizuan sebashku me statusin e tyre si nje gjykte e detyrueshme e shkalles se pare. Shkak per kete ndryshim u be numri gjithnj e me i vogel i shume ndermarrjeve te privatizuara dhe te porsa-krijuara si pasoje e ristrukturimit ekonomik, gje qe me pare e bente te pamundur ngritjen e komiteteteve te arbitrimit.<sup>3</sup> Per me teper, keto komitete konsideroheshin si sajesa te nje shteti socialist, qe i perkiste ideologjise se demokracise ne fabrike.

---

<sup>2</sup> Akti II I vitit 1967, Neni 66/A

<sup>3</sup> Kodi i Punes i vitit 1967 diktonte ngritjen e ketyre komiteteteve ne cdo ndermarrje ku kishte sindikate. Sipas Aktit te ri mbi te drejten e shoqatave- Akti II i vitit 1989- duhen se paku 10 vete per te krijuar nje sindikate; shumica e ndermarrjeve te reja kane me pak se 10 punemarres.

- **Mosmarreveshjet kolektive ne pune** (mosmarreveshjet e interesit) njireshin dhe rregulloreshin si nje lloj i ri mosmarreveshje. Ne te kaluaren, mosmarreveshjet e interesit nuk njireshin (nuk pranoheshin) zyrtarisht. Sipas doktrines socialiste, marredheniet midis punetoreve dhe punedhenesve bazoheshin ne harmonine e plete te interesave te tyre.
- U be i mundur depozitimi i **kerkesave\_ne Gjykaten** (vendore) te Apelit per **te gjitha llojet e ceshtjeve**, mbi te cilat kishte juridikcion Gjykata e Punes.
- Pas nje vendimi te Gjykates Kushtetuese, punetoret **nuk mund te perfaqesheshin nga sindikakat** per ceshtjet e mosmarreveshjeve ne pune, pa nje autorizim paraprak nga punetoret e interesuar.
- Sindikatat nuk merrnin me **ndihme ligjore** te financuar nga shteti.
- Legjislacioni i ri bente dallim midis mosmarreveshjeve te interesit dhe mosmarreveshjeve mbi ligjin e punes (**dy llojeve te mosmarreveshjeve ne pune**).
- Zbatimi i te drejtave te punes mbeshtetet nga **sanksione publike (morale) dhe procese te vecanta** (psh. penalitetet e dhena nga inspektoriati i punes ose fillimi i procedurave penale);
- Kushtetuta Hungareze, gjithashtu edhe nje ligj i vecante garantojne<sup>4</sup> **te drejten per greve** si mjet presioni per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te interesit.

## Llojet e mosmarreveshjeve ne pune

### *Mosmarreveshjet kolektive ne pune*

Legjislacioni i ri rregullon te dy llojet e mosmarreveshjeve ne pune: mosmarreveshjet kolektive (te interesit) dhe mosmarreveshjet mbi ligjin e punes. Mosmarreveshjet kolektive ne pune jane te ashtu-quajturat mosmarreveshje interesi<sup>5</sup>. Perkufizimi i ketyre mosmarreveshjeve jepet nga Kodi i Punes: “Cdo mosmarreveshje qe lind ne nje marredhenie pune (mosmarreveshje kolektive ne pune) midis punedhenesit dhe keshillave te punes ose midis punedhenesit (organizata e perfaqesimit te interesave te punedhenesit) dhe sindikates, qe nuk cilesohet si mosmarreveshje ligjore, zgjidhet me ane te bisedimeve mes paleve te interesuara” (Neni 194, paragrafi 1).

Keto mosmarreveshje kategorizohen sipas aktoreve, llojit te konfliktit dhe procedurave.

*Aktoret* ne mbeshtetje te punetoreve mund te jene vetem “aktore kolektive”, te tille si sindikatat dhe keshillat e punes; ndersa pala tjeter jane: punedhenesi (t) ose organizata e punedhenesve.

Ligji nuk pershkruan asnje kriter mbi te drejten qe kane sindikatat per t'u perfshire (per te marre pjese) ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve kolektive ne pune. Per rrjedhoje, cdo sindikate (me se paku nje anetar ne vendin respektiv te punes) mund te ndermarre zgjidhjen e nje mosmarreveshje me punedhenesin, pavaresisht nga statusi i perfaqesimit ose e drejta per te lidhur marreveshje kolektive.

<sup>4</sup> Akti VII i vitit 1989 mbi te drejten per greve.

<sup>5</sup> Kodi I Punes, Pjesa IV, Mosmarreveshjeve ne pune, Kapitulli 1, Mosmarreveshjet kolektive ne pune, Neni 194-196.

Persa i perket keshillave te punes, si keshillat vendore ashtu edhe keshillat qendrore<sup>6</sup>, kane te drejte te ndermarrin zgjidhjen e mosmarreveshjeve kolektive ne pune; kjo e drejte i takon gjithashtu perfaquesuesve individuale te punes<sup>7</sup>.

Ne tryezen e bisedimeve, sindikata mund te perfaquesohet nga kryetari ose nga nje person tjeter qe sipas statutit ka te drejten e perfaqesimit, ose nga dikush tjeter qe autorizohet nga kryetari i sindikates.

Edhe keshillat e punes mund te ushtrojne te drejtat e tyre te zbatueshme.

Punedhenesi mund te perfaquesohet nga nje drejtues i nivelit te duhur (psh. ai qe kryeson keshillat qendrore te punes duhet te jete drejtori i pergjithshem, ndersa ne nivelin vendor drejtori i uzines eshte partneri i duhur per te zhvilluar bisedime me perfaquesuesit e sindikates).

Subjekti i nje mosmarreveshje kolektive ne pune mund te klasifikohet ne vartesi te aktoreve. Mosmarreveshjet e interesit qe paraqiten nga sindikata kane te bejne me kontratat kolektive dhe kushtet materiale qe punedhenesi i siguron sindikates ne vendin e punes (psh. perdomimi i ambjenteve). Keshillat e punes ndermarrin zgjidhjen e mosmarreveshjeve kolektive ne pune ne vartesi te tre faktoreve: (i) te lidhjes se nje marreveshje kolektive me punedhenesin, (ii) te shpenzimeve financiare per zgjedhjen e keshillave te punes dhe shpenzimeve operacionale<sup>8</sup>, dhe (iii) te ceshtjeve qe kane te bejne me te drejtat e keshillave te punes per bashke-vendosje, informacion dhe keshillim.

Ndonjehere, eshte e veshtire te besh dallim midis mosmarreveshjeve te interesit dhe mosmarreveshjeve ligjore ne nje situate te dhene. Psh. punedhenesi duhet te siguroje ambjente per sindikatat. Gjithesesi, permasat, vendndodhja etj.e ambjenteve te tilla jane objekt i nje marreveshjeje te perbashket; mos-arritja e kesaj marreveshje mund te cilesohet si mosmarreveshje kolektive (interesi) ne pune.

#### ***Procedura e zgjidhjes se mosmarreveshjeve kolektive ne pune***

Persa u perket ketyre mosmarreveshjeve, ligji u dikton paleve **detyrimin per pajtim** dhe ne te njejten kohe u ofron te zgjedhin tre menyra pajtimi.

Forma me e bute e pajtimit nenkupton **angazhimin e paleve ne dialog te drejtperdrejte** per zgjidhjen e problemit. Bisedimet nisin kur pala qe merr persiper te beje pajtimin, i paraqet nje deklarate me shkrim pales tjeter. Ky eshte nje element i rendesishem i procesit, sepse ne shume raste mosmarreveshjet lindin nga mungesa e informacionit te duhur.

---

<sup>6</sup> Keshilli i punes ose perfaquesuesi i punemarresve zgjidhet ne nje vend te caktuar pune vetem kur menazheri ne ate vend pune ka te drejte, pjeserisht apo teresisht, te ushtroje te drejtat e punedhenesit ne lidhje me te drejtat e keshillit te punes. (Kodi i Punes,Neni 43, paragrafi 3).

<sup>7</sup> Nese ka me shume se nje keshille pune ose me shume se nje perfaquesues te punemarresve tek nje punedhenes, atehere krahas keshillave lokale te punes krijohet nje keshill qendor pune. Anetaret e ketij te fundit mund te delegohen nga keshillat lokale te punes ne raport me numrin e punetoreve te punesuar ne vendin e punes qe ata perfaquesojne (Neni 44, paragrafi 2).

<sup>8</sup> Punedhenesit mbulojne shpenzimet e zgjedhjes se justifikuar te keshillave te punes si edhe shpenzimet operacionale qe caktohen me marreveshje te perbashket. Cdo mosmarreveshje ne kete drejtim, zgjidhet me ane te bisedimeve (Kodi i Punes, Neni 63).

Marrja e masave, qe qendron ne themel te mosmarreveshes, nuk behet e mundur gjate zhvillimit te bisedimeve, te cilat nuk zgjasin me shume se **shtate dite**; gjithashtu palet nuk mund te ndermarrin asnje veprim qe mund te terezikoje marreveshjen.

Nese palet nuk arrijne mirekuptim gjate bisedimeve, ato mund t'i drejtohen ndermjetesuesit ose arbitruesit.

Per zgjidhjen e konfliktit, palet mund te pajtojne sherbimet e nje ndermjetesuesi te pavarur. Palet mund te kerkojne bashkarisht pranine (pjesemarrjen) e ndermjetesuesit. Ndermjetesuesi mund te jete kushdo qe eshte i gatshem te veproje si i tille: nuk ka kritire kufizuese ligjore (per sa kohe qe ndermjetesuesi eshte i pavarur si nga ceshtja ashtu edhe nga palet). Gjate bisedimeve, ndermjetesuesi mund t'i kerkoje informacion paleve, ne ate mase qe ai e gjykon te nevojshme. Me perfundimin e bisedimeve, ndermjetesuesi ben nje permbledhje me shkrim per qendrimin e paleve dhe per perfundimin e bisedimeve. Gjithashtu, ai i paraqet raportin paleve, ndonese nuk ka te drejte te vendose per mosmarreveshjen.

**Arbitrimi** mund te jete rruga me efikase e zgjidhjes se mosmarreveshjeve kolektive ne pune. Arbitruesi mund te vendose per mosmarreveshjet dhe vendimi i tij eshte detyrues, nese palet kane rene dakord me shkrim paraprakisht. Arbitruesi mund te ngreje nje komitet pajtimi ku palet delegojne nje numer te barabarte perfaquesuesish. Arbitrues mund te jete cilido.

Ndersa bisedimet e drejtperdrejta midis paleve dhe ndermjetesimi jane gjithmone procese vullnetare qe zgjidhen nga palet, arbitrimi ne disa raste mund te jete i detyrueshem. Prania e arbitruesit eshte e detyrueshme ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne ceshtjet e me poshtme: kur palet nuk bien dakord mbi te drejten qe ka sindikata per te informuar anetaret e vet mbi ceshtje qe ajo i konsideron te rendesishme; kur punedhenesi nuk siguron ambjente te pershatshme per sindikaten; kur palet nuk bien dakord per shpenzimet e keshillit te punes qe duhen mbuluar nga punedhenesi; dhe se fundi, per te drejtat e keshillit te punes per bashke-vendosje.

Gjate bisedimeve, gjate procesit te ndermjetesimit dhe arbitrimit, palet mund te konsultojne eksperte ose deshmitare sipas nje **marreveshje** te dyaneshme.

Mosmarreveshjet **perfundojne** ose kur palet arrijne **mirekuptim** (ne rastin e bisedimeve te drejtperdrejta dhe ndermjetesimit) ose me **vendim te arbitruesit**.

Si marreveshja ashtu edhe vendimi i arbitruesit, mund te konsiderohen si **marreveshje kolektive** dhe si te tilla jane ligjerisht te detyrueshme.

### *Shpenzimet e procedures*

Shpenzimet e nevojshme per kryerjen e bisedimeve dhe per arbitrim mbulohen nga punedhenesi, me perjashtim te rasteve kur merret nje vendim tjeter.

Kur nuk arrijne mirekuptim, palet nuk demshperblehen ligjerisht, gje qe con ne bisedime te metejshme, madje edhe ne greve.

### ***Sherbimi i Ndermjetesimit dhe Arbitrimit te Punes (SHNAP)<sup>9</sup>***

Pasi proceset e ndermjetesimit dhe arbitrimit u perfshire ne Kodin e Punes, u pa se ishte e veshire te gjendeshin individe, qe ishin te gatshem te sherbenin si ndermjetesues dhe arbitrues, dhe qe palet te binin dakord per ta. Hungaria nuk kishte tradite ne kete process, keshtu qe palet nuk kishin nga te merrnin pervoje. Gjithashtu, ne rastin e mosmarreveshjeve armiqesore, palet nuk gjenin gjuhe te perbashket dhe as qe mund te behej fjale per te zgjedhur nje ndermjetesues ose arbitrues.

Me qellim gjetjen e zgjidhjeve per mosmarreveshjet e interesit,u krijua nje sherbim i posacem, Sherbimi i Ndermjetesimit dhe Arbitrimit. Sherbimi i ri u ngrit ne Korrik te vitit 1996 nga Keshilli Kombetar i Pajtimit te Interesave (KKPI)<sup>10</sup>. Sherbimi financohet nga buxheti i shtetit; drejtori dhe sekretari perkates emerohen si nepunes civile nga Ministri i Punes ne marreveshje me KKPI. Pavaresisht nga kjo, Sherbimi dhe ndermjetesuesit/arbitruesit jane te pavarur nga Ministria dhe nga qeveria. Sherbimi jep llogari perpara Keshillit Kombetar te Pajtimit te Interesave; drejtori duhet t'i paraqese nje raport vjetor KKPI-se mbi veprimtarine e SHNAP-it.

Sherbimi i ndermjetesimit dhe arbitrimit sigurohet nga lista e ndermjetesuesve dhe arbitruesve te pavarur. Ndermjetesuesit e mundshem perzgjidhen nga KKPI.

Ndermjetesues mund te behet kushdo qe permbush kushtet e meposhtme: te kete nenshtetesi hungareze, diplome universitare (ne cdo dege, jo domozdoshmerisht ne drejtesi), pese vjet pervoje ne marredheniet e punes, aftesi per te trajtuar konfliktet, aftesi te mira komunikuese. Kandidatet testohen dhe perzgjidhen nga nje komitet tri-palesh.

Aktualisht egziston nje liste me 98 ndermjetesues, nga e cila mund te perzgjedhin palet ne mosmarreveshje.

Ndermjetesuesit regjistrohen ne liste per pese vjet nga Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale. Ne Fletoren Zyrtare botohet nje njoftim ku pershkruhet profesioni, pervoja, arsimimi, zona gjeografike nga vijne (rajon) dhe sektori ku ata punojne.

Palet ne mosmarreveshje mund te perzgjedhin bashkarisht nje person nga lista. Nese nuk bien dakord, ata i kerkojne Sherbimit te propozoje kandidate te tjere. Drejtori i Sherbimit- mbi bazen e informacionit te paleve per pikat kryesore te mosmarreveshjes – perzgjedh 3-5 vete nga lista sipas rendit alfabetik, nga te cilet palet mund te perzgjedhin kandidatet.

Ndermjetesuesit jane te pavarur si nga palet ashtu edhe nga Sherbimi. Ata paguhen vetem per punen ndermjetesuese qe kryejne, dhe pasi zgjidhen si ndermjetesues/arbitrues, duhet te lidhin nje kontrate me Sherbimin (ne rastin e arbitrimit te detyrueshem- me punedhenesin).

SHNAP-i jep te dhena dhe informacione te tjera mbi konfliktin per te lehtesar punen e ndermjetesuesve.

---

<sup>9</sup> Munkaiügyi Közvetítő és Döntőbirói Szolgálat.

<sup>10</sup> Organizmi tri-palesh per dialogun social ne nivel kombetar. Ai perbehet nga perfaquesues te organizatave kombetare te punetoreve dhe punedhenesve dhe qeverise.

Shpenzimet dhe shperblimet e ndermjetesuesve mbulohen nga SHNAP-i, kurse arbitruesit paguhen nga punedhenesi.

Shperblimi i ndermjetesuesve ulet, sa me gjate te vazhdoje mosmarreveshja (qe vleresohet cdo dy vjet) dhe paguhet cdo dite deri ne tete dite, e shumta. Ne kete menyre, Sherbimi kerkon te inkurajoje palet dhe ndermjetesuesin qe ta zgjidhin mosmarreveshjen sa me shpejt te jete e mundur.

Sherbimi i jep ndermjetesuesve/arbitruesve te dhena mbi ceshtjen dhe ndihme administrative. Ai organizon programe trajnimi per ndermjetesuesit e regjistruar. Sherbimi ka Kodin e vet Etik, qe percakton qendrimin qe duhet te mbajne ndermjetesuesit.

Udhezimet e Perhershme te Sherbimit miratohen nga KKPI.

Udhezimet e Perhershme se bashku me listen e ndermjetesuesve botohen ne Fletoren Zyrtare.

Sipas raportit vjetor te drejtorit, ne vitin 2002, numri i kerkeseve per ndermjetesues dhe arbitrues drejtuar Sherbimit, ishte goxha i ulet. U paraqiten vetem 19 kerkesa, gjashte nga te cilet kerkonin te ishin ndermjetesues dhe dy arbitrues; ne pese raste palet kerkonin vetem keshilla, ndersa pjesa tjeter e rasteve nuk ishte ne kompetencen e Sherbimit.

### **Mosmarreveshjet mbi ligjin e punes**

Lloji i dyte i mosmarreveshjeve ne pune, i parashikuar ne Kodin e Punes, nenkupton mosmarreveshjet mbi ligjin e punes, qe kane te bejne me marredheniet individuale ne pune ose me marredheniet kolektive ne pune. Keto mosmarreveshje priren te lindin nga shkelja e te drejtave te punetoreve ose te punedhenesve ose te aktoreve ne nje marredhenie pune.

*Kategorizimi ligjor i mosmarreveshjeve mbi ligjin e punes.* Ne vijim te petacioneve (kerkesave) qe lidhen me marredheniet e punes ose ne perputhje me Ligjin, me marreveshjet kolektive ose me marreveshjet ne pune, punedhenesit, sindikatat dhe keshillat e punes mund te ndermarrin veprime ligjore lidhur me punen, ne perputhje me Ligjin. Nese ligji nuk e parashikon ndryshe, punedhenesi mund te ndermarrjeve ligjore per zgjidhjen e ceshtjeve te punes.<sup>11</sup>

Rrethi i aktoreve qe preket dukshem nga mosmarreveshje te tilla eshte mjaft i gjere: edhe punemarresit mund te jene pale e tyre. Me shkelje ligjore kuptojme si dhunimin e ligjit ashtu edhe dhunimin e marreveshjes kolektive (Kodi i Punes, Pjesa IV, Kapitulli II, Neni 199-202). Gjithsesi, ky ligj ka nje perjashtim: ceshtjet qe lidhen me vendimet e miratuara nga punedhenesi brenda lirise se veprimit qe ai ka, mund te trajtohen vetem nese punedhenesi ka shkelur ligjin qe ka te beje me keto vendime.

### **Afati/Kohezgjatja**

Procesi ligjor hapet brenda afatit te caktuar, me perjashtim te rasteve kur padia pret te protokollohet brenda 30 ditesh nga njoftimi i bere, ne lidhje me:

---

<sup>11</sup> Kodi i Punes,Neni 199, paragrafi 2.

- Plotesimin e kontrates se punesimit qe zbatohet kur punedhenesi merr vendim te njeanshem;
- Mbarimin i nje marredhenie punesimi, edhe kur ajo behet me pelqimin (miratimin) e ndersjelle te paleve;
- Pezullimet e pamotivuara nga puna;
- Pasojat ligjore te pafavorshme per shkak te shkeljes se detyrimeve nga punemarresi;
- Njoftim me shkrim per te kerkuar ripagimin e pagave<sup>12</sup> [12] dhe kompensimet per demet, perfshi pagesen qe duhet te beje punemarresi per te mbuluar perjegjesite materiale.

Akti ligjor nuk duhet te kete efekt te vonuar ne zbatimin e veprimit (ky rregull ka shume pak perjashtime).

### **Procesi**

Mosmarreveshjet mbi interpretimin e ligjit te punes mund te zgjidhen vetem ne gjyq. Si punemarresit/sindikatat/keshillat e punes ashtu edhe punedhenesit duhet ta ndjekin ceshtjen ne gjyq. Ky rregull i perjithshem ka vetem tre perjashtime dhe ne keto raste vetem punedhenesi ka autoritetin te vendose:

- Demshperblimin qe duhet te paguajne punemarresit per te mbuluar demet e shkaktuara nga ata vete, perfshi kompensimin per mungesat ne inventar, sikurse sanksionohet ne marreveshjen kolektive;<sup>13</sup>
- Njoftim qe kerkon ripagimin e pagave;<sup>14</sup>
- Masa disiplinore.<sup>15</sup>

Gjithesesi, vendimi i punedhenesit mund te kundershtohet ne gjyq. Ne mungese te nje kundershtimi te tille, vendimi i punedhenesit eshte perfundimtar.

### **Pajtimi**

Ne Hungari, ligji i punes nuk rregullon format e perjithshme dhe te detyrueshme te **zgjidhjes alternative te mosmarreveshjeve**, si arbitrimi apo gjyqi (tribunali).

---

<sup>12</sup> Te gjitha rrogat e paguara te cilat nuk duhej te ishin paguar mund te reklamohen nga punemarresi brenda 60 diteve nga vendimi i bere me shkrim. Punedhenesit mund t'i bejne kerkese me shkrim punemarresve per pagesen ne lidhje me detyrimet e punesimit (Neni 162 i Kodit te Punes).

<sup>13</sup> Punedhenesi mund t'i paraqese gjykates pretendimet lidhur me demet e shkaktuara nga punemarresi. Marreveshja kolektive percakton se deri ne c'mase jane detyrimet e punemarresit. Edhe ne kete rast, procedura standarte per percaktimin e demeve vendoset nga marreveshja kolektive. (Neni 173 i Kodit te Punes).

<sup>14</sup> Shih shenimin 13.

<sup>15</sup> Ne rastet kur punemarresi shkel rende nje detyrim te percaktuar ne kontraten e punes, marreveshja kolektive parashikon kushte ligjore, pervec dispozitave lidhur me pezullimet e pamotivuara nga puna, si edhe percakton rregullat perkatese te procedures (Neni 109, paragrafi i Kodit te Punes)

Ne marreveshjen kolektive ose ne kontraten e punes, qe synojne arritjen e nje mirekuptimi, mund te perfshihet nje klauzole qe detyron pajtuesin te marre pjese ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne pune. Bisedimet mund te nisin me pajtuesin, i cili me pas perpilon (harton) marreveshjen me shkrim.

Nuk ka rregulla ligjore per zgjedhjen qe ben dhe per procedurat qe perdor pajtuesi: ato mund te percaktohen nga palet e perfshira mbi baze te miratimit te ndersjelle.

Pajtuesi mund te jete cilido person per te cilin palet bien dakord. Sherbimi i Ndermjetesimit dhe Arbitrimit te Punes (SHNAP)-nuk ka autoritetin te nderhyje: sfera e ketij Sherbimi kufizohet ne mosmarreveshjet kolektive ne pune.

Qysh prej vitit 2002, ka hyre ne fuqi nje ligj i ri<sup>16</sup> i amenduar kohet e fundit, i cili u vjen me tej ne ndihme paleve kundershtare per te zgjidhur mosmarreveshjet.

Ne rastet e ligjit civil dhe te mosmarreveshjeve ne pune, palet ne mosmarreveshje mund te angazhojne edhe nje person te trete, te paanshem, te pavarur (person juridik ose person fizik) qe te ndermjetesoje dhe t'i ndihmoje ata te arrijne nje perfundim ose nje marreveshje me shkrim.

Ndermjetesuesit regjistrohen nga Ministria e Drejesise dhe lista e tyre botohet ne Fletoren Zyrtare te Ministrise se Drejesise.

Kriteret e pranimit te ndermjetesuesve dhe arbitruesve jane: diplome universitare (jo domozdoshmerisht ne Drejesi) dhe se paku pese vjet pervoje ne kete fushe, te mos kete te kaluar kriminale etj. Individet duhet te aplikojne per t'u regjistruar si ndermjetesues. Regjistrimi behet ne baze te nje vendimi te Ministrise se Drejesise. Ne rast refuzimi, kandidati mund te apeloje ne gjykate.

Perzgjedhja e ndermjetesuesit behet mbi bazen e nje marreveshje te perbashket. Ndermjetesuesi ka te drejte te pranoje ose te refuzoje ftesen e paleve.

Ligji rregullon normat dhe parimet baze te procesit te ndermjetesimit: psh. ndermjetesuesi duhet t'i degjoje palet ne kushte te barabarta. Procesi zhvillohet ne prani te dy paleve ose ne sesione te vecanta, me miratimin e paleve. Pas konsultimit me palet, ndermjetesuesi mund te ftoje eksperte si edhe persona te tjere ne proces.

Shpenzimet mbulohen nga palet mbi bazen e nje marreveshje te perbashket. Ndermjetesuesi bie dakord me palet per shperblimin.

Procesi mbyllt pas arritjes se marreveshjes. Ne rastet kur marreveshja nuk arrihet, procesi gjyqesor mbyllt pas kater ditesh nga fillimi i tij. Marreveshja mund te konsiderohet si nje marreveshje e thjeshte e ligjt civil. Pavaresisht nga kjo, palet mund te shkojne ne gjyq edhe pas arritjes se mirekuptimit.

---

<sup>16</sup> Akti LV i vitit 2002 mbi veprimtarine e ndermjetesimit. Akti u miratua nga Parlamenti ne 3 Dhjetor 2002.

## Sistemi gjyqesor

### Struktura

Ne Hungari, gjykatat e specializuara te punes u ngriten ne vitin 1972, me qellim trajtimin e mosmarreveshjeve mbi ligjin e punes. Gjykatat e punes funksionojne si gjykata te shkalles se pare.

Mundesia e apelimit ne Gjykaten Rajonale egziston per te gjitha rastet. Ne nivelin e shkalles se dyte, procesi behet perseri pjese e sistemit tradicional te gjykates civile. Ne Gjykaten Rajonale ka gjykata te specializuara pune, ku avokatet e specializuar ne ceshtjet e punes trajtojne raste qe kane te bejne me punen dhe me sigurine sociale.

### Sfera/Fusha

Sfera e gjykatave te punes shtrihet ne te gjitha ceshtjet qe lidhen me punen, perfshi mosmarreveshjet individuale dhe kolektive ne pune, si edhe ne ceshtjet qe lidhen me inspektimin e punes, me sigurine dhe shendetin ne pune (te ashtuquajturat vendime administrative publike) dhe ceshtjet e sigurise sociale.

### Perberja

Gjykatat e punes organizohen ne cdo vend dhe ne cdo kryeqytet<sup>17</sup>. Ato perbehen nga tre anetare, nje gjykates profesionist dhe dy gjykates amatore. Gjykatesit amatore zgjidhen nga asambleja e per gjithshme e keshillit vendor. Si rregull, qytetaret, qeverisja vendore dhe organizatat civile – perfshi sindikatat dhe organizatat e punedhenesve, si edhe organizatat e pensionisteve- kane te drejte te caktojne kandidate. Sipas ligjit, gjykatesit amatore qe emerohen ne gjykatat e punes, ne radhe te pare, caktohen nga perfaquesues te interesave te punemarresve dhe punedhenesve. Shumica e gjykatesve amatore jane pensioniste. Persa i perket perberjes se gjykates, tribunali nuk ka asnjë detyrim ligjor te perfshire nje perfaquesues te punemarresve dhe nje perfaquesues te punedhenesve ne cdo ceshtje; tre anetaret e tij, pavaresisht nga perberja e gjykates, qe si rregull nuk eshte “tri-paleshe”, caktohen nga presidenti i gjykates<sup>18</sup>.

Perpara se te nisin veprimtarine e tyre, gjykatesit amatore duhet te bejne betimin. Brenda procesit gjyqesor ata gezojne te njejtat te drejta sikurse gjykatesit profesioniste. Ne rast mosmarreveshje, anetaret e gjykates duhet te votojne pro ose kunder, per rrjedhoje gjykatesit amatore mund te marrin nje vendim qe eshte ne kundershtim me gjykatesin profesionist. Ne raste te tilla gjykatesi profesionist, ne pakice, ka te drejte t’ia bashkangjise mendimin e tij me shkrim gjykimit zyrtar ne nje zarf te vulosur. Zarf hapet (nga gjykata e apelit) vecse ne rast apelimi.

Nese gjykatesit amatore jane te punesuar, punedhenesi duhet te vazhdoje t’i paguaje pagen mesatare; nese nuk jane te punesuar ata kane te drejte te shperblehen nga shteti ne masen 25% te pages me te ulet qe marrin gjykatesit profesioniste.

---

<sup>17</sup> Aktualisht, ka 20 gjykata pune: 1 ne secilin nga 19 rajonet/rrethet dhe 1 ne Budapest.

<sup>18</sup> Akti LXVII mbi statusin ligjor dhe shperblimin e gjykatesve, Kapitulli XI: Statusi ligjor dhe shperblimi i gjykatesve amatore.

Gjykata e apelit perbehet nga tre gjykates profesioniste. Vendimi i saj eshte perfundimtar. Ne raste te vecanta, Gjykata e Larte protokollon nje peticion te posacem brenda 60 diteve nga vendimi i Gjykates se Apelit.

### **Procedura**

Ne mosmarreveshjet mbi ligjin e punes, aplikohen rregullat e procedures civile,nese kapitulli i vecante i procedures se Kodit Civil<sup>19</sup> nuk parashikon gje tjeter lidhur me ceshtjet e punes.

Rregullat e vecanta proceduriale mbi mosmarreveshjet ne pune perfshijne si me poshte:

- Kryetari i gjykates **duhet te nise proceduren me nje perpjekje per pajtim** midis paleve ose perfaquesuesve te tyre, me qellim arritjen e marreveshjes. Gjate kesaj pjese te procesit, gjykatesi e diskuton ceshtjen me palet dhe merr ne konsiderate te gjitha rrethanat e njoitura.
- Nese pajtimi deshton, atehere fillon gjyqi.
- **Procesi i pare gjyqesor planifikohet** te zhvillohet brenda 15 diteve nga paraqitja e ceshtjes ne gjyq.
- **Perparesi** u jepet rasteve qe synojne te rivendosin marredhenien e perfunduar te punes.
- Per ceshtjet qe synojne pagimin e rrogave ose paraqitjen e dokumenteve te nevojshme nga ana e punedhenesit pas mbarimit te marreveshjes se punes, gjykaka mund te diktoje **marrjen e masave te perkoheshme**.
- Sindikatat kane te drejte te **perfaqesojne** anetaret e vet ne gjykate, sipas nje autorizimi te rregullt, perpara ndonje autoriteti tjeter apo nje agjencie per ceshtje qe kane te bejne me kushtet e jeteses dhe te punes,
- Organizatat e punedhenesve mund te autorizohen nga anetaret e vet, qe te perfaqesoohen ne Gjykaten e Punes.
- Keshillat e punes, sindikatat dhe organizatat e punetoreve qe nuk kane individualitet (personalitet) ligjor, mund te jene pale ne nje veprim ligjor.<sup>20</sup>[20]
- Per ceshtje urgjente, Gjykata merr vendim brenda 15 diteve nga hapja e procesit gjyqesor (psh. per mosmarreveshje qe lidhen me caktimin ose zgjedhjen e keshillave te punes; ben verejtje (kur sindikata ve veton); per mosmarreveshje mbi te drejten per te lidhur nje kontrate kolektive; per shkelje te te drejes se keshillave te punes per informacion dhe konsultim.
- Punedhenesit duhet t'i justifikojne te gjitha veprimet e tyre me shkrim nese punemarresi i demtuar ka te drejte te kerkoje demshperblim/zhdemtim ligjor prej tyre. Ne raste te tilli, punemarresi njoftohet ne kohen e duhur lidhur me menyren dhe afatin kohor per dhenien e demshperblimit.

---

<sup>19</sup> Akti III i vitit 1952 mbi Proceduren Civile, Kapitulli XXIII, Neni 349,paragrafi 1.

<sup>20</sup> Keshillat e punes nuk kane individualitet ligjor, ndersa sindikatat dhe organizatat e punetoreve jane entitete ligjore, por vetem pasi regjistrohen nga Gjykata e Rrethit. Gjithesesi, ato mund te jene pale ne nje mosmarreveshje ligjore ne gjykate, psh. kur mbrojne perfaquesuesit e zgjedhur nga pezullimet e padrejta ne punë.

Nese punemarresi nuk e paraqet ceshtjen brenda afatit te parashikuar sepse nuk eshte njoftuar ne kohen e duhur, atehere gjykata e merr parasysh kete shpjegim.

### ***Shpenzimet e procedures gjyqesore***

Ne mosmarreveshjet mbi ceshtjet e punes, palet kane te drejte te **perjashtohen nga shpenzimet gjyqesore**. Megjithate, ata punedhenes qe e humbin ceshtjen, duhet t'i perballojne vete shpenzimet e gjyqit.

Sidoqofte, shperblimi i avokateve (keshilltareve ligjore), nuk ben pjese ne shpenzimet gjyqesore dhe si i tille duhet te paguhet nga palet ne mosmarreveshje.

Pala e deleguar (perfshi edhe punetoret e deleguar) duhet te mbuloje gjithashtu edhe shperblimin e avokatit te pales tjeter.

Sindikatat mund te punesojne avokate per te perfaquesuar anetaret e vet ne gjykate apo perpara ndonje autoriteti tjeter, lidhur me mosmarreveshjet per problemet e punes. Keta avokate paguhen nga sindikata. Nese punemarresi e humbet ceshtjen, ai detyrohet te paguaje shpenzimet e avokatit te pales tjeter. Gjithesesi, ne shume raste, sindikatat marrin persiper shpenzimet ne emer te punetoreve.

### ***Zbatimi i ligjit te punes***

Disa kategori te te drejtave te punes (te punetoreve) mbeshteten jo vetem nga ligji i punes dhe procedura civile (mosmarreveshjet ne pune, mundesia per t'u paraqitur ne gjykaten e punes), por gjithashtu edhe me rruge administrative. Procedurat e inspektimit te punes<sup>21</sup> perdoren psh. ne raste te tilla si diskriminimi, shkelja e te drejtave te grave, te rinjve dhe te gjymtuarve (te paaftave) punetore; shkelja e orarit te punes, e kohes se pushimit ose e rregullores se pagave; shkelja e te drejtes per t'u organizuar, e rregullave qe kane te bejne me perfaquesuesit e punetoreve dhe e te ashtu-quajturave kontrata pune fallco ( per te shmangur kontributet e sigurimeve shoqerore, etj) Inspektoret e punes mund t'u vene gjobe punedhenesve dhe mund/duhet te diktojne perfundimin e veprimtarive ilegale; ata kane gjithashtu te drejte te ndalojne punen ne te zeze dhe t'i detyrojne punedhenesit te perm bushin detyrimet e tyre.

Fatkeqesisht, efektiviteti i inspektimit te punes nuk eshte i larte per shkak te numrit te vogel te inspektoreve.<sup>22</sup>

Nje rruga tjeter e mundeshme per te nxitur zbatimin e legjislacionit te punes ne inspektimin e procedurave, eshte perdonimi i procedurave ligjore kunder kujdo qe shkel te drejtat e punetoreve si: diskriminimi, shkelja e ligjit per lidhjen ose mbarimin e marredhenieve te punes ose e rregullores se pagave, shkelja e se drejtes se perfaquesuesve te punetoreve, punesimi ilegal i te huajve, shkeljet qe lidhen me punen provizore te agjencive dhe shkelja e sigurimit dhe shendetit ne pune. Ne vitin 2003 hyri ne fuqi nje instrument i ri mjaft i rendesishem per mbrojtjen e punetoreve. Ligji i ri mbi trajtimin e barabarte dhe mbi mundesi

---

<sup>21</sup> Akti LXXV i vitit 1996 mbi inspektimin e punes.

<sup>22</sup> Ne Hungari jane punesar me pak se 200 inspektore pune per te monitoruar sigurimet shoqerore dhe shendetore ne pune, si edhe shkeljet e te drejtave te tjera te punes.

te barabarta<sup>23</sup> parashikonte mundesine e ‘veprimit te interesave publike’ (action popularis) ne rastet e diskriminimit ne grup.

Edhe organizatat qe perfaqesojne interesat civile, perfshi sindikatat, mund te ndermarrin veprime ligjore lidhur me mosmarreveshjet ne pune.

Ne fushen e mosmarreveshjeve kolektive ne pune, legjislacioni eshte i mire por ai nuk gjen zbatim praktik per shkak te burimeve te pamjaftueshme. Ka gjasa qe zgjidhjet te gjenden ne mundesite qe kane partneret sociale per lidhjen e kontratave kolektive, psh: a kane force partneret sociale te rregullojne marredheniet e tyre ne nje marreveshje kolektive? Po ligji i inkurajon partneret sociale te hyjne ne bisedime dhe te konsultohen me njeri tjeterin dhe a ka shtysa te mjaftueshme qe i nxisin ata te marrin pjese ne dialogun social? Kur ligji rregullon gjithcka me imtesi, ka shume hapesire per mosmarreveshjet e interesit.

Ne fushen e mosmarreveshjeve ligjore, duket se eshte e nevojshme te gjendet nje proces alternativ pajtimi qe t'i paraprije procedures se gjykates, qe eshte e paanshme dhe e pavarur dhe ku mund te marrin pjese si perfaqesuesit e punedhenesve ashtu edhe ata te punetoreve.

## Perfundime

Ne fushen e mosmarreveshjeve kolektive ne pune, legjislacioni eshte i mire, por ai nuk gjen zbatim praktik per shkak te burimeve te pamjaftueshme. Ka te ngjare qe zgjidhjet mund te gjenden ne mundesite qe krijojne kontratat kolektive te arritura nga partneret sociale: psh. a kane partneret sociale hapesire te mjaftueshme per rregullimin e marredhenieve te tyre ne nje kontrate kolektive? A i inkurajon ligji partneret sociale per te hyre ne bisedime dhe per t'u keshilluar me njeri tjeterin dhe a ka nisma te mjaftueshme qe ata te behen pjese e dialogut social? Kur ligji rregullon gjithcka ne menyre te hollesishme, nuk ka hapesire te mjaftueshme per konflikte interesit.

Ne fushen e mosmarreveshjeve ligjore, duket se eshte e nevojshme futja e nje procesi alternativ pajtimi perpara procedures gjyqesore, qe eshte e pavarur dhe e paaneshme dhe ne te cilien marrin pjese si punedhenesit ashtu edhe punetoret.

---

<sup>23</sup> Akti CXXV i vitit 2003, Neni 20.



# **Gjykatat e Punes ne Zvicer**

## **Studime te Rastit**

**Jean-Claude Prince<sup>1</sup>**

### **Gjykata e Punes ne Republiken dhe Kantonin e Jures**

#### **Hyrje**

Ne Mesjetë, ne France gjykatesit te cilet konsideroheshin si njerez te urte dhe te denje per te dhene keshilla, quheshin ‘*prud’hommes*’. Me 1806 Napoloni themeloi ‘*Keshillin i te urteve*’ ne Lion. Roli i Keshillit ishte zgjidhja e mosmarreveshjeve te vogla midis fabrikanteve dhe punetoreve ne kete qytet te madh industrial. Nje dekret i nxjerre ne vitin 1809 lejonte shtrirjen e gjykatave te tilla edhe ne qytete te tjera. Aty nga viti 1847, Franca kishte 75 gjykata te tilla.

Ne 1811, Napoloni i shtriu ‘*Conseils de prud’hommes*’ne Belgike dhe ne Luginen e Rinit. ‘*Tribunaux de fabriques*’ (gjykatat e fabrikes) me pas u krijuan ne Prusi, ndersa ne rajonet e tjera te Gjermanise, gjykatat e punes u ngriten vetem ne qytetet kryesore industriale.

Ne Itali, ‘*Conseil de probiviri*’ u ngrit ne Komo per industrine e mendafshit jo me pare se viti 1878. Legjislacioni lejonte shtrirjen e gjykatave te tilla ne te gjithe vendin, por thjesht mbi baza fakultative.

Lindja dhe zhvillimi i levizjes sindikaliste aty nga fundi i shekullit te 19-te dhe me tej, krijoj kushtet qe keto industri te perfshinin nje numer te barabarte te punedhenesve dhe te punemarresve. Si fillim, ato u shfaqen ne levizjen punetore si vegla te borgjezise per te siguruar dhe ruajtur rendin e vendosur ne leverdi te vet.

Ne Zvicer, sipas Kushtetutes Federale (Neni 122.2), organizatat e ligjshme, ceshtjet proceduriale dhe administrimi i drejtësise perfshihen brenda juridikzionit te secilit prej 26 kantoneve (distrikteve) dhe gjysme-kantoneve qe perbejne vendin.

Keto gjykata civile te specializuara bejne te mundur krijimin e fushave te vecanta ligjore. Ligji e kufizon juridikzionin e vet ne disa lloj ceshtjesh/rastesh ne vartesi te objektit qe ato trajtojne (gjykatat e dhenies se qirave, gjykatat tregtare, gjykatat e punes ose ‘*keshillat e te urteve*’).

Gjykata e pare zvicerane e punes, u ngrit ne Gjeneve ne vitin 1883, e bazuar ne modelin Francez. Ne vitin 1885, shembullin e saj e ndoqi Neuchatel, nje principate Prusiane, por ne kete rast ajo u mbeshtet mbi modelin Gjerman. Si rezultat i zhvillimit te shpejte industrial ne Zvicren e fundshekullit te 19-te, shembullin e tyre e ndoqen menjehere kantonet dhe gjysme-

---

<sup>1</sup> Sekretar Qendor i Unionit Sindikal te Zvicerës

kantonet e Vaudit (1888), te Bâle-Ville (1889), Soleure (1891), Lucerne (1892), Berne (1894), Zurih (1895), Fribourg (1899), Saint-Gall (1897), Argovie (1908) and Valais (1924).

Ne vijim te nje Referendum i mbajtur nga sindikatat dhe partite e krahut te majte, kantoni i fundit zviceran (1979), Republika dhe Kanton i Jures (me 65.000 banore) ne vitin 1983 krijoj gjithashtu nje ‘Keshill te te Urteve’ (gjykate pune), e cila perben edhe objektin e ketij studimi. Tiparet themelore te kesaj gjykate jane procedurat e drejtperdrejta, te cilat jane falas dhe te mundshme/te arritshme per te gjithe.

## **Gjykata e punes ne Republiken dhe Kantonin e Jures**

### **1. Te pergjithshme**

- 1.1. Gjykata e punes eshte nje gjykate *de première instance* (gjykate e shkalles se Pare).
- 1.2. Kodi i Procedures Civile, per analogji, aplikohet ne te gjitha rastet qe nuk mbulohen nga legjislacioni i vendosur ne Gjykatene e punes.

### **2. Juridiksoni**

- 2.1. Gjykata e Punes vendsos per te gjitha mosmarreveshjet qe lindin midis punedhenesve dhe punemarresve lidhur me kontraten e punes, me perjashtim te:
  - 2.1.1. Mosmarreveshjeve midis autoriteteteve publike ose institucioneve, qe trajtohen me ligjin e nepunesit civil dhe stafit qe trajtohet me te njejtin ligj.
  - 2.1.2. Mosmarreveshjeve qe i referohen gjykatave speciale ose gjykatave te arbitrimit me ligje apo konventa te tjera.
  - 2.1.3. Veprimeve kriminale qe kane te bejne me mosmarreveshjet brenda ketij juridiksoni dhe kerkesave civile qe rrjedhin prej tyre.
- 2.2. Kur nuk ka perputhje ligjore, vendimi merret nga Gjykata Civile e Tribunalit Kantonian.

### **3. Struktura organizative**

- 3.1. Anetaret e Gjykates se punes caktohen per 4 vjet
- 3.2. Ata e marrin detyren ne te njejten kohe sikurse gjykatesit dhe nepunesit.
- 3.3. Gjykatesi i Gjykates se shkalles se pare kryeson Gjykatene e punes.
- 3.4. Gjykata e Shkalles se pare cakton nje kryesekretar te Gjykates se punes si edhe nje zevendes, nga stafi i zyres se regjistrimit.

#### **4. Grupet profesionale dhe sektionet**

- 4.1. Grupi 1: orendreqes, zejet qe punojne me metal, metalurgji, inxhineri mekanike, elektricitet, elektronike, plastike dhe cdo industri tjeter e lidhur me to.
- 4.2. Grupi 2: ndertim, industria e drurit, inxhineri civile, miniera, bujqesi, pylltari, rritja e peshkut, kopshtari, blegtori dhe sektore te tjere qe lidhen me to.
- 4.3. Grupi 3: Industri dhe tregti ushqimore, duhani, tregtia me shumice, tekstilet, kepuçet, industria e veshjeve, artet grafike, sherbimet (hoteleri dhe tregtia e restoranteve, bankat, sigurimet), profesionet e lira, spitalet dhe veprimtari te tjera.
- 4.4. Mosmarreveshjet ne rastet kur ndermarrja i takon nje grupi te caktuar, zgjidhen nga Kryetari i Gjykates Kantonale.
- 4.5. Cdo grup ndahet ne sektionin e punedhenesit dhe sektionin e punemarresit.
- 4.6. Nuk mund te besh pjese ne te dy sektionet ose tek te dy grupet njehersh.
- 4.7. Personat qe mund te nenshkruejne individualisht apo kolektivisht akte detyruese ne emer te ndermarrjes ose te kompanise, si: drejtoret, menazheret apo perfaqesuesit e autorizuar qe perfshihen ne regjistrin e tregut, konsiderohen gjithashtu punemarres.

#### **5. Juridiksoni/ Ligjshmeria**

##### **5.1. Kryetari**

- 5.1.1. Udheheq procedimet dhe sesionet plenare.
- 5.1.2 Jep vete vendime mbi mosmarreveshje qe vlejne me pak se 8.000 franga (baraz me gati dy muaj page mesatare)
- 5.1.3. Ve veton per masat provizore te bazuara ne kontratat industriale (e punes).
- 5.1.4. Drejton procedimet dhe zbaton gjykimin.
- 5.1.5. Drejton seancat e pajtimit.
- 5.1.6. Perpunon aplikimet per proceduren e grumbullimit te te dhenave aty ku ka rrezik qe ato te zhduken apo te demtohen.

##### **5.2. Gjykata e Punes**

- 5.2.1. Kur vlera e procesit gjyqesor eshte e pakta 8 000 franga, Gjykata e Punes perbehet nga kryetari, kryesekretari dhe dy gjykates vleresues (nje perfaqesues i punedhenesve dhe nje perfaqesues i punemarresve).

##### **5.3. Emerimi i gjykatesve**

- 5.3.1. Gjykatesit emerohen nga kryetari perpara zhvillimit te cdo seance dhe perzgjidhen nga radhet e gjykatesve te grupeve profesionale (gjysma e tyre nga sezioni i punedhenesve dhe gjysma tjeter nga sezioni i punemarresve).

5.3.2. Kur kjo nuk eshte e mundur, kryetari cakton nje gjykates nga nje grup tjeter profesional i te njejtit sektor. Ne menyre qe Gjykata e punes te jape nje gjykim te drejte, shumica e gjykatesve duhet te kete marre pjese ne te gjitha procedurat e nevojshme ne menyre qe ta kuptoje ceshtjen.

#### 5.4. Kryesekretari

- 5.4.1. Kryesekretari eshte ne dispozicion te publikut ne orarin e percaktuar dhe te shpallur nga Gjykata e punes.
- 5.4.2. Kryesekretari viziton qytetet kryesore te tre distrikteve (shkon me sherbim).
- 5.4.3. Kryesekretari jep informacion falas per te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me juridikacionin e Gjykates se punes.
- 5.4.4. Kryesekretari ben perpjekje te perafroje pozicionet e paleve dhe nese eshte e nevojshme i therret ata ne takim.
- 5.4.5. Kryesekretari merr aplikimet e bera nga Gjykata e punes.
- 5.4.6. Kryesekretari harton raportin e sesionit plenar; perqigjet per ceshtjet administrative dhe per korrespondencen. Gjithashtu, ai administron Regjistrin dhe perqigjet per mbajtjen e llogarise.

#### 5.5. Mosparaqitja e gjykatesit

- 5.5.1. Cdo gjykates qe nuk asiston ne seancen degimore ose qe nuk paraqitet pa nje justifikim te vlefshem ne kohen e duhur, gjobitet nga kryetari dhe detyrohet te paguaje shpenzimet e shkaktuara nga mungesa ose vonesa e tij.
- 5.5.2. Nese me pas ai ben nje shfajesim te vlefshem, ndeshkimi anullohet.

### 6. Mospranimi

- 6.1. Kur nje anetar ose kryesekretari i Gjykates se punes nuk pranohet qe te gjykoje, atehere aplikohen dispozitat e Kodit te Procedures Civile.
- 6.2. Kërkesa hidhet poshte nga Gjykata Kantonale ne momentin qe pala ne fjale terhiqet dhe zevendesohet nga vartesi i vet.
- 6.3. Ne rast se te gjithe apo shumica e anetareve te Gjykates se punes refuzohen, atehere vendos Gjykata Civile. Nese ajo deklaron se refuzimi eshte i bazuar, seanca degimore i kalon Gjykates se punes, te perbere nga anetare te tjere qe nuk jane refuzuar.

### 7. Ambjentet dhe stafi

- 7.1. Shteti siguron ambjentet e nevojshme dhe stafin e duhur te Gjykates se punes.
- 7.2. Seancat e Gjykates se punes zhvillohen ne nje salle mbledhjesh dhe jo ne sallat e gjyqit (per te mos i dhene procedures karakter gjyqesor, sic nenkupton edhe termi '*prud'hommes*').

## **8. Parimet qe udhehequin emerimet**

- 8.1. Ne cdo seksion emerohen tre vleresues, sipas rregullave te percaktuara ne nenet e meposhtme.
- 8.2. Nga e njejtë kompani, mund te emerohet vetem një gjykates per seksion.
- 8.3. Gjykata e punes paraqitet ne seance sipas rendit te caktuar per procedime dhe vendime

## **9. E drejta per t'u zgjedhur**

- 9.1. Kushtet per t'u zgjedhur percaktohen ne perputhje me legjisacionin mbi organizimin e procedurave gjyqesore.
- 9.2. Gjithashtu, kandidatet duhet te kene qene te punesar te pakten 6 muaj ne nje kompani brenda grupit te interesuar.

## **10. Aplikimet**

- 10.1. Kater muaj perpara se Gjykata te nise pune, Gjykata Kantonale boton kerkesen per aplikime ne Fletoren Zyrtare dhe shperndan formularet qe duhen mbushur.
- 10.2. Aplikimet duhet te paraqiten ne Gjykaten Kantonale brenda 30 ditesh nga data e njoftimit.
- 10.3. Aplikimet duhet te firmosen nga kandidati; ato perfshijne daten e lindjes, adresen dhe profesionin e kandidatit, kompanine qe ai drejton ose qe e ka punesar, daten e fillimit te punes dhe punen qe ben. Te huajt duhet te paraqesin një certificate qe provon se ata gezojne te drejta politike. Nese aplikimet jane te dyshimta, kryetari i Gjykates Kantonale ben verifikimet e duhura dhe eleminon kandidatet e papershtatshem.

## **11. Emerimet**

- 11.1 Nese ka me shume kandidate te pershatshem sesa vende pune, Gjykata Kantonale i therret kandidatet ne takim, duke i dhene perparesi kandidateve te propozuar nga sindikata dhe nga organizatat e profesioneve.
- 11.2. Ne rast te kundert, kandidatet emerohen automatikisht nga Gjykata.
- 11.3. Nese ne nje seksion te dhene nuk ka kandidate te mjaftueshem, atehere Gjykata Kantonale u kerkon organizatave te interesuara te bejne propozime te tjera. Nese nuk ka te tilla, aplikantet njoftohen me telefon dhe pas kesaj Gjykata ben emerimet.
- 11.4. Nese nuk paraqitet ndonje nga anetaret gjate periudhes se caktuar, Gjykata Kantonale ben nje emerim te ri deri ne fund te asaj periudhe mbi baze te propozimit qe vjen nga organizata e profesioneve.

11.5. Gjykata Kantonale e boton listen e gjykatesve te emeruar ne Fletoren Zyrtare.

## **12. Paga neto**

- 12.1. Paga neto e kandidatit ruan vleren e aplikimit dhe nuk merr parasysh ankesat.
- 12.2. Paga neto perbehet nga kostoja e plete, minus kontributet e sigurimeve shoqerore, sigurimet shendetore dhe tatimin mbi page.

## **13. Dorezimi i aplikimeve**

- 13.1. Personat qe duan ta paraqesin ceshtjen ne Gjykaten e punes, i drejtohen kryesekretarit te Gjykates ose me shkrim ose me goje, duke bere nje permblehdje te mosmarreveshjes ne fjale dhe duke nxjerre konkluzione.
- 13.2. Cdo aplikim qe i drejtohet nje autoriteti i cili nuk ka juridikcionin perkates, percillet pa vonese ne Gjykaten Tribunale nga kjo e fundit, pa pasur asnje paragjykim per aplikantin. Palet njoftohen menjehere.

## **14. Pajtimi**

- 14.1. Kryesekretari ben perpjekje qe ta zgjidhe mosmarreveshjen brenda paleve dhe i therret ato vec e vec.
- 14.2. Ne raste urgjente, ata mund te thirren menjehere.
- 14.3. Kryesekretari therret palet te paraqiten tek kryetari me qellim pajtimin, nese ato vete jane dakord.
- 14.4. Cdo zgjidhje konflikti shenohet ne regjistrin kryesor dhe firmoset nga palet.
- 14.5. Keto zgjidhje jane ligjerisht te detyrueshme.

## **15. Pergatitja per seancen degjimore**

- 15.1. Nese perpjekja per pajtim deshton, kryesekretari shenon çeshtjet kryesore dhe ia percjell ato kryetarit. Nese ky i fundit e quan te nevojshme, u rekomandon paleve te shkembejne mendime lidhur me mosmarreveshjen. Nese procedurat bazohen mbi argumente, kryetari lejon qe pala e paditur te jape kunder-argumente.
- 15.2. Ne rastet kur aplikimi fillestar eshte bere i argumentuar, kryetari lejon palen e paditur te jape kunder-argumente.

- 15.3. Kryetari therret palet, cakton diten, kohen dhe vendin per t'i degjuar. Thirrja permban edhe konkluzionet e aplikimeve si edhe nje shenim mbi pasojat ligjore per demin e shkaktuar.

## **16. Paraqitja ne seancen degjimore**

- 16.1 Palet paraqiten personalisht dhe e argumentojne çeshtjen gojarisht.
- 16.2. Nese nje nga palet nuk lejohet te marre pjese per arsyen qe njihen nga kryetari, ajo mund te perfaqesohet nga nje person i rritur i familjes, me ane te nje prokure, ose nga nje person qe ushtron te njejtin profesion apo eshte i punesar ne te njejten kompani.
- 16.3. Kur prania e paleve nuk eshte e domozdoshme ne seancen degjimore, atehere kryetari lejon qe ata te mos paraqiten personalisht nese perfaqesohen nga nje person tjeter i autorizuar (agjent).

## **17. Ndihma /Asistanca**

- 17.1. Ne seancen degjimore te pajtimit, palet mund te ndihmohen nga nje agjent ose nga dikush qe e kane zgjedhur ato vete.

## **18. Agjentet/ Ndihmesit**

- 18.1. Palet mund te therrasin nje agjent qe t'i perfaqesoje gjate procesit, qe t'i ndihmoje dhe te plotesoje kerkesat proceduriale ne vend te vete paleve.
- 18.2. Agjente pranohen personat e meposhtem:
- 18.2.1. Juriste te autorizuar
  - 18.2.2. Perfaquesues te organizatave te punemarresve dhe punedhenesve (lokale, rajonale dhe kantonale) qe perfshihen ne listen e mbajtur per kete qellim nga Gjykata e Kantonit.
  - 18.2.3. Nga punedhenesit, Drejtues te larte te kompanise.
- 18.3. Dispozitat e Kodit te Procedures Civile aplikohen per agjente qe nuk jane juriste te autorizuar.

## **19. Ndihma ligjore falas**

- 19.1. Kryetari i cakton pales nje jurist me kerkesen e vet per sa kohe qe ai i keshillon falas.

## **20. Gjuhet**

- 20.1. Procedimet zhvillohen ne gjuhen frengje.

- 20.2. Personat qe nuk e kuptojne Frengjishten ose ata qe nuk e dine mire ate, mund te flasin ne gjuhen e tyre amtare. Kur eshte e mundur, Shteti ve ne dispozicion nje perkthyes pa pagese (falas).

## **21. Karakteri publik i procedures dhe rregullorja**

- 21.1. Procedurat e gjykates se punes zhvillohen ne publik. Rastet caktohen sipas rregullave te zakonshme proceduriale, por periudha kohore shkurtohet sa me shume te jete e mundur.
- 21.2. Kohezgjatja normale e procedures nuk shtyhet per ditet e festave publike ose per pushimet verore.
- 21.3. Masat provizore te percaktuara nga Kodi i Procedures Civile dhe zbatimi i vendimeve rregullohen me procedure permblehdhese.

## **22. Percaktimi i fakteve**

- 22.1. Gjykata e punes percakton faktet.
- 22.2. Formularet per te dhenat nuk para-percaktohen nga ligji.

## **23. Diskutimet dhe votimi, dhenia e vendimit**

- 23.1. Sapo degjohet fjala e fundit e pales se paditur, Gjykata Tribunale mbidhet ne nje seance te myllur dhe jep vendimin.
- 23.2. Vendimi u jepet paleve me goje, duke i bere te ditur mundesine per apelim.
- 23.3. Palet mund te vodosin te mos e pranojne vendimin me goje, dhe per kete rast kerkojne qe pjesa ekzekutive e vendimit t'u jepet me shkrim.
- 23.4. Ne rast apelimi, jepet nje permblehdje e shkurter me shkrim e vendimit.

## **24. Apeli**

- 24.1. Cdo vendim i Gjykates se punes mund te jete i apelueshem ne kushtet e dhe ne perputhje me Kodin e Procedures Civile.
- 24.2. Kur penaliteti eshte me pak se 8,000 franga, palet mund t'i kerkojne kryetarit te anulloje vendimin e Gjykates Tribunale.
- 24.3. Afati per apel eshte 30 dite nga data e dhenies se vendimit.

## **25. Procedura para Gjykates Civile**

- 25.1. Agjentet e autorizuar (juriste, perfaquesues te shoqatave te punedhenesve dhe punemarresve ose ndryshe drejtues te larte te kompanise ne fjale) lejohen te perfaquesojne dhe ndihmojne palet para Gjykates Civile.
